

# *Rregullat e* ***shitblerjes***

*Meshhur Hasen*



## RREGULLAT E SHITBLERJES

Shkëputur nga libri:  
"el Uexhiz fi Fikhis Suneti uel Kitabil Aziz"  
(Përmbledhës në fikhun e Sunetit dhe Librit të Shtrenjtë)  
Autor: Abduladhim bin Bedeui el Halefi  
Shtojcë: "Pasuria dhe gjykimi për të!"  
Autor:shejh Mesh'hur ibën Hasen Al Selman  
(Allahu e ruajt!)  
Përktheu: Ebu Enes Bledar HOXHA  
Boton: Libraria "Imam Albani"  
e-mail: imamalbani\_libri@yahoo.com

### PËRMBAJTJA

#### PARATHËNIE

#### KAPITULLI I SHITBLERJES

#### Ç'është shitblerja

#### Gjykimi për shitblerjen

#### Nxitja për të arritur jetesën me djersë

#### Nuk ka ndalim të pasurohesh nëse i frikësohesh Allahut në të

#### Nxitja për të qënë ekonomik në kërkimin e rrizkut

#### Nxitja për të qënë i sinqertë dhe ndalimi nga gënjeshtria

#### Nxitja për lehtësim dhe falje në shitblerje

#### Dobia në konsiderimin e atij që është ngusht

#### Ndalimi i mashtrimit

#### Nxitja për t'u ngritur herët në kërkimin e rrizkut

#### Çfarë thuhet kur hyn në treg

#### Allahu e ka bërë të lejuar shitblerjen

#### Llojet e shitblerjes të cilat i ka ndaluar sheriat

#### Bejul-garar

#### Shitja me të prekur dhe me të hedhur

#### Shitja e të voglit të të voglit të barsës

#### Shitja me guraleca

#### - Shitja e diçkaje që nuk e posedon në të vërtetë

#### - Shitja e mallit që ke blerë para se ta marrësh në dorë

#### - Shitja mbi shitjen e vëllait tënd (tregtarit tjetër)

#### - Shitja e Ijnes (me hile)

#### - Shitja me afat duke rritur çmimin (shitja me këste)

#### Gjërat të cilat nuk lejohet shitja e tyre

#### ZGJEDHJA

#### Llojet e zgjedhjes

#### KAMATA

#### Ç'është kamata

Gjykimi për kamatën

Llojet e kamatës

Gjërat në të cilat ndalohet kamata

**MARRËVESHJA NË KULTIVIMIN E TOKËS**

Ç'është marrëveshja në kultivim

Gjykimi për të

Kujt i takojnë shpenzimet

Çfarë nuk lejohet në këtë lloj tregtie

**MARRËVESHJA NË PËRKUJDESJEN PËR PEMËT**

Ç'është marrëveshja në përkujdesjen për pemët

Gjykimi për të

**NGJALLJA E TOKËS SË VDEKUR**

Ç'është toka e vdekur

Nxitja e Islamit për tek ajo

**QIRAJA**

Ç'është qiraja

Gjykimi për qiranë

jërat në të cilat lejohet qiraja

Qiraja (paga) e punëtorit

Gjynahu i atij që nuk ia jep hakun punëtorit

Gjërat në të cilat nuk lejohet qiraja

Qiraja në leximin e Kuranit

**SHOQËRITË TREGTARE**

Ç'është shoqëria tregtare

Gjykimi për shoqërinë tregtare

Shoqëria tregtare sipas sheriatit

**AZHIOTAZHI**

Ç'është azhiotazhi

Gjykimi për azhiotazhin

Besnikëria e punëtorit

**PARAPAGIMI**

Ç'është parapagimi (es-selem)

Gjykimi për të

Parapagimi atij që nuk e posedon bazën e mallit (farën)

**BORXHI**

Dobia e borxhit

Shtrëngimi në të

Ai që merr të hollat e njerëzve dhe ka për qëllim t'i kthejë ato

Urdhëri për shlyerjen e borxhit

Mirësjellja në kërkimin e kthimit të borxhit

Shtyrja e afatit të atij që është ngushtë:

Mosshlyerja e borxhit prej atij që ka mundësi është padrejtësi

Izolimi i atij që ka mundësi të shlyejë borxhin dhe nuk e bën

Çdo borxh që sjell fitim është kamatë

**PENGU**

Ç'është pengu

Gjykimi për pengun

A lejohet përdorimi i pengut

**TRANSFERIMI I PARAVE**

Ç'është transferimi i parave

**DEPOZITIMI**

Ç'është depozitimi

Gjykimi për të

Kompensimi i amanetit nëse priset në dorën e mbajtësit

**HUADHËNIA**

Ç'është huadhënia

Gjykimi për të

Urdhëri për kthimin e huasë

Kompensimi i saj nëse priset

**GJËJA E GJETUR**

Ç'është gjëja e gjetur

Detyra e atij që gjen diçka të humbur

Delet dhe devetë e humbura

Gjetja e gjërave që hahen dhe atyre pa vlerë të konsiderueshme

Gjëja e gjetur në Harem (në territorin e Kabes)

**FËMIJA I GJETUR**

Gjykimi për të

Feja e tij, liria dhe shpenzimi për të

Trashëgimia e fëmijës së gjetur

Pohimi i prejardhjes së tij

**DHURATA**

Ç'është dhurata

Nxitja në të

Pranimi i dhuratës edhe nëse është pak

Dhurata që nuk refuzohet

Kush ka më shumë të drejtë për t'i dhuruar atij

Ndalimi nga bërja dallim mes fëmijëve në dhuratë

Nuk lejohet që ndokush të kërkojë atë që dhuroi dhe as ta blejë atë

Gjykimi për atë që bën një dhuratë dhe më pas e trashëgon atë

Dhurata që marrin nëpunësit është e pamerituar

**MARRJA E DIÇKAJE ME FORCË**

Gjykimi për të

Ndalimi nga përfitimi i të marrurës me dhunë

Kush vritet duke ruajtur pasurinë e tij, është dëshmor

Rrëmbimi i tokës

**ESH SHUFAH**

Ç'është esh shufah  
 Gjërat në të cilat pranohet Shufah  
 Shufah e komshijve që kanë diçka të përbashkët  
**AUTORIZIMI**  
 Ç'është autorizimi (el Uekale)  
 Gjykimi për të  
 Gjërat në të cilat lejohet autorizimi  
 I autorizuari duhet të jetë besnik  
 Pasuria dhe gjykimi për të

## PARATHËNIE

Falenderimet i takojnë vetëm Allahut, vetëm Atë falenderojmë, prej Tij kërkujmë ndihmë dhe falje të gjynaheve tona. I lutemi Allahut të na ruaj nga e keqja e veteve dhe punëve tona! Atë të cilin e udhëzon Allahu, është i udhëzuar dhe atë të cilin humb Allahu nuk do të gjendet askush për ta udhëzuar. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është rob i Allahut dhe i dërguari i Tij.

Disa vëllezër të mi më kërkuan që t'iu përgatis një material përmbledhës në rregullat e shitblerjes, duke u ankuar se libra të tillë në gjuhën shqipe nuk ka fare, ose janë shumë të rrallë. Kështu, duke parë këtë nevojë të vëllezërve të mi muslimanë për këtë degë të fikhut Islam dhe për vetë rëndësinë e kësaj teme, ku siç dihet, shitblerja është diçka e përditshme dhe të gjithë e praktikojnë për plotësimin e nevojave të tyre, mora shkas për përgatitjen e këtij libri. Kjo të bën të kuptosh edhe shkakun e lejimit të shitjes dhe ndalimin e kamatës. Shitja është e dobishme dhe e domosdoshme për njerëzit në përgjithësi, ndërsa kamata është shkatërruese e ekonomisë së popujve në përgjithësi dhe grumbullim i saj në duart e një pjese të vogël njerëzish, të cilët janë të pasurit.

Prej këtu kuptohet kapitalizmi dhe sherri i tij mbi njerëzimin. Qëllimi i tij është që i pasuri të shtojë pasurinë e tij, kurse i varfëri të zhytet edhe më shumë në varfëri. Njerëzit të punojnë shumë dhe të posedojnë pak.

Pikërisht kjo është ajo që fshihet pas kamatës (fajdes), shkatërrueses së ekonomisë së popujve dhe ky është shkakun që Islami e ka ndaluar rreptësisht kamatën, ndërsa Allahu i ka shpallur luftë atij që e merr apo e jep atë.

**"O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun dhe ndërprisni çfarë ju ka mbetur nga kamata (këtej e tutje), në qoftë se jeni me të vërtetë besimtarë. Dhe në qoftë se nuk e bëni këtë, atëherë merrni njoftimin për luftë nga Allahu dhe i Dërguari i Tij. Nëse do të pendoheni, atëherë merrni origjinën e pasurisë tuaj. Kështu që as nuk i bëni askujt padrejtësi as nuk iu bëhet padrejtësi." (Bekare:278-279)**

Ndërsa në anën tjetër komunizmi kërkon heqjen e pronës private nga rrënjët dhe zëvendësimin e saj me pronën e përbashkët, duke rënë kështu ndesh me natyrën njerëzore në dëshirën për të poseduar. Në mes këtyre dyjave, qëndron Islami me drejtësinë e tij në të gjitha fushat e jetës si dhe sistemin ekonomik. Sistemet joislame të ekonomisë, na nxisin të mësojmë sistemin Islam dhe praktikimin e tij për zgjidhjen e problemeve ekonomike, për të qenë kështu brenda rregullave të shariatit. Libri që keni në duar, është një përmbledhje e thjeshtë dhe e qëlluar e autorit, në të cilin janë përfshirë thujtë të gjitha çështjet e fikhut të shitblerjes dhe marrëdhënieve ekonomike. Libri është hartuar në mënyrë të tillë, ku në fillim janë vendosur temat e nëntemat, pastaj domethëniet e tyre, gjykimi i shariatit për to të argumentuar nga Kurani dhe Suneti. Vlen të përmendim se të gjitha hadithet me të cilat autori është argumentuar, janë të sakta dhe shumë prej tyre gjenden në dy librat e saktë (sahihat) të haditheve atë të Buhariut dhe Muslimit. Nëse hadithi ndodhet te Buhariu, jemi mjaftuar vetëm me përmendjen e tij, sepse dihet që është i saktë (sahih), por në rast se hadithi është i mirë (hasen) e kemi shënuar. Të gjitha hadithet e tjera, që nuk gjenden te Buhariu apo Muslimi, kemi shënuar në kllapa gradën e hadithit, gjykimi i të cilëve është marrë nga librat e shejh Muhamed Nasirudin Albanit (Allahu e mëshiroftë!).

I lutem Allahut të Lartësuar të më fal mua dhe vëllezërit e mi muslimanë, të na e bëjë të kuptueshëm Islamin dhe Ligjet e Tij si dhe të na japë sukses në praktikimin e tyre!

Allahu është Zoti i kësaj dhe i Vetmi që mundet për këtë!

**Ebu Enes**  
**Janar 2004**  
**Jordani**

## **KAPITULLI I SHITBLERJES**

### **Çështje shitblerja**

Shitja është kalimi i diçkaje që ke në pronësi te dikush tjetër kundrejt një vlere, ndërsa blerja është pranimi i asaj pronësie.

### **Gjykimi për shitblerjen**

Allahu i Lartësuar thotë:

**"Allahu e ka bërë të lejuar tregtinë (shitblerjen) dhe e ka bërë të ndaluar kamatën"1**

**"O ju që keni besuar! Mos e hani pasurinë tuaj pa të drejtë ndërmjet jush, vetëm nëse bëni tregti me pëlqimin e njëri-tjetrit."**<sup>1</sup>

Transmeton Hakim bin Hizam (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Shitësi dhe blerësi janë të lirë në zgjedhje deri sa të ndahen nga njëri-tjetri."<sup>3</sup>

Të gjithë muslimanët janë bashkuar (ixhma) në mendimin se shitblerja është e lejuar. Edhe urtësia e përmban këtë, sepse nevojat e njerëzve shpesh lidhen me diçka që është në duart e dikujt tjetër, që ndoshta nuk ia përkushton atij, kështu që me lejimin e shitblerjes arrihet nevoja pa ndonjë problem.

### **Nxitja për të arritur jetesën me djersë**

Transmeton Mikdami (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Askush nuk ka ngrënë ushqim më të mirë se ai i duarve të tij. Edhe i Dërguari i Allahut, Daudi (Paqja e Allahut qoftë mbi të!) hante prej punës së duarve të tij."<sup>4</sup>

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Më mirë për ndonjërin prej jush është të mbajë dru mbi shpinën e tij (për t'i shitur), se sa t'i kërkojë njerëzve që mund t'i japin apo mund mos t'i japin."<sup>5</sup>

### **Nuk është e ndaluar të pasurohesh nëse i frikësohesh Allahut në të.**

Muadh bin Abdullah bin Hubejb transmeton nga babai i tij dhe ky nga xhaxhai i tij se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Nuk është e ndaluar të kesh pasuri nëse i frikësohesh Allahut në të. Shëndeti për të devotshmin është më i mirë se pasuria..."<sup>6</sup>

---

1.Suretu Bekare:275.

2.Suretu Nisa:29.

3.Mutefekun alejhi.

4.Buhariu.

5.Buhariu, Tirmidhiu, Nesaiu.

6.Ibnu Maxheh (sahih).

---

### **Nxitja për të qenë ekonomik në kërkimin e rrizkut.**

Xhabir bin Abdullah (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"O njerëz! Kini frikë Allahun dhe kërkoheni rrizkun në të lejuar (hallall), sepse nuk do të vdesë ndonjë trup pa plotësuar rrizkun e tij edhe nëse ai i vonohet. Kini frikë Allahun dhe kërkoheni rrizkun mirë! Merrni atë që është e lejuar (hallall) dhe lini atë që është e ndaluar (haram)."7

### **Nxitja për të qenë i sinqertë dhe ndalimi nga gënjeshtria.**

Hakim bin Hizam transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Shitësi dhe blerësi janë të lirë në zgjedhje deri sa të ndahen. Nëse ata janë të sinqertë dhe të qartë (në tregtinë e tyre), atëherë tregtia e tyre ka begati; nëse i fshehin dhe mashtrojnë njëri-tjetrin, atëherë tregtia e tyre zhvishet nga begati."8

Ukbetu bin Amir (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thotë se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) të thotë:

"Muslimani është vëlla i muslimanit. Nuk i lejohet muslimanit që t'i shesë vëllait të tij diçka që ka ndonjë të metë, vetëm nëse ia bën atë të qartë."9

### **Nxitja për lehtësim dhe falje në shitblerje.**

Xhabir bin Abdullah (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Allahu e mëshiroftë atë person i cili është falës kur shet, falës kur blen dhe falës në gjykatë!"10

### **Marrja në konsideratë e atij që është ekonomikisht i pamundur.**

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Një tregtar u jepte borxh njerëzve dhe nëse shihte ndonjë që nuk kishte të paguante, i thoshte punëtorëve të tij: "Faljani atij se ndoshta Allahu na fal neve!" Atëherë Allahu e



fali atë."11

### **Ndalimi i mashtrimit.**

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë:

---

7.Ibnu Maxheh (sahih).

8.Mutefekun alejhi.

9.Ibnu Maxheh (sahih).

10.Buhariu.

11.Buhariu.

---

"I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) kaloi pranë një burri që shiste një lloj ushqimi. Futi dorën e tij në të dhe pa që ai ishte i përzierë (lart i mirë dhe brenda i keq), atëherë tha:

"Nuk është prej nesh ai që mashtron."12

### **Nxitja për t'u ngritur herët në kërkimin e rizkut.**

Sahr el Gamidi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thënë:

"O Zoti im! Jepi bereqet popullit tim në mëngjesin e herët të tij (në punën që fillojnë që herët në mëngjes)."13

### **Ç'thuhet kur hynë në treg.**

Salim bin Abdullah bin Umer (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton nga babai i tij, e ky nga gjyshi i tij se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Kush thotë kur hynë në treg: *La ilahe il lAllah uahdehu la sherike lehu, lehul mulku ue lehul hamdu, juhji ue jumijtu, ue huue hajun la jemutu, bijedih el hajru kul luhu, ue huue ala kul li shejin kadijr* (Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut të Pashok. I Tij është sundimi dhe Atij i takon falenderimi Ai jep jetë dhe vdekje, Ai është i Gjallë dhe nuk vdes. Në Dorën e Tij është e gjithë e mira dhe Ai është i mundshëm për çdo gjë), atij Allahu i shkruan një milion të mira, i fshin një milion të këqia dhe i ndërton një shtëpi në

xhenet."14

## Allahu e ka bërë të lejuar shitblerjen.

Shitblerja në origjinë, e çdo lloji qoftë ajo, është e lejuar nëse dy palët janë në një dhe të kënaqur me të dhe nëse nuk ka gjë të ndaluar nga sheriat.

## Llojet e shitblerjes të cilat i ka ndaluar sheriat.

### 1. *Bejul garar*.

Është çdo shitblerje që përmban njohuri jo të plota (të fshehta që nuk i di njëra palë apo të dyja) ose që përmban rrezikshmëri apo kumar.

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë:

---

12.Ibnu Maxheh Ebu Daud, Tirmidhi, Muslim (sahih).

13.Ibnu Maxheh, Tirmidhi, Ebu Daud (sahih).

14.Ibnu Maxheh (hasen)

---

"I Dërguari i Allahut ka ndaluar nga shitja me guraleca<sup>15</sup> dhe nga shitja e *gararit* (mosnjohjes së plotë të mallit)."16

Imam Neueuiu (Allahu e mëshiroftë!) në komentimin e tij të "Sahihul Muslim", thotë:

"Shitja e gararit është një bazë e madhe prej bazave të kapitullit të shitblerjeve dhe për këtë shkak Muslimi e filloi këtë kapitull me të. Në këtë lloj shitblerje hyjnë shumë çështje të pakufizuara, si: shitja e të arraturit, shitja e asaj që nuk ekziston, shitja e asaj që nuk e njih, asaj që nuk ke mundësi ta dorëzosh te blerësi, asaj që nuk e ke akoma në pronësi, shitja e peshkut që është në ujë apo lumit, e qumeshtit në gji, e asaj që ndodhet në barkun e kafshës barsë, e një robeje prej rrobeve (e papërcaktuar), një dashi prej deshëve e të tjera si këto, shitblerja e të cilave është batil (e kotë), e papranueshme, e palejuar, sepse është gabim (verbëri) i panevojshëm. Nëse nevoja kërkon ndonjëherë që të kryhet ndonjë lloj *garari* (gabimi verbërisht) që është e pamundur të ruhesh prej tij, vetëm se me stërmundime dhe nëse gabimi është i arsyetueshëm, atëherë shitblerja lejohet. Muslimanët janë bashkuar në mendimin se shitblerja e xhybes së mbushur (me pambuk a diçka tjetër) është e lejuar edhe nëse ata nuk e hapin për ta parë çka brenda. Por nëse shitet vetëm mbushja e saj, atëherë kjo shitblerje nuk lejohet. Dije se shitja e të prekurit (nëse prek mallin atëherë duhet ta blesh atë që preke), shitja e litarit (ato që kap litari që zgjat je i detyruar t'i blesh), shitja e guralecave, e të tjera si këto, janë prej

shitblerjeve për të cilat kanë ardhur tekste të veçanta (në ndalimin e tyre). Të gjitha ato hyjnë në ndalimin e shitjes së gararit (verbërisë), por ato janë përmendur të veçuara për shkak se kanë qenë prej shitblerjeve të njohura në kohën e injorancës, para Islamit. Allahu e di më së miri”.

### **Shitja me të prekur dhe me të hedhur.**

Transmetohet nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se ka thënë:

"Jemi ndaluar prej dy shitblerjeve; shitja me të prekur (el mulamese) dhe shitja me të hedhur (el munabedhe). "el mulamese" është prekja e çdonjërit prej dy personave rroben (plaçkën) e tjetrit pa dashje, kurse

---

15. Shitja me guraleca është një lloj tregtie e cila praktikohej në kohën e injorancës dhe kryhej duke hedhur disa guraleca mbi mall dhe malli ku binin guralecat bëhej i detyrueshëm të blihej. Muslim, Tirmidhi, Ebu Daud, Ibnu Maxheh, Nesai (sahih).

---

"el munabedhe" është hedhja e çdonjërit prej atyre dyve rroben e tij tek tjetri pa parë njëri prej tyre rroben e tjetrit."17

Ebu Seid el Hudri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thotë:

"Na ka ndaluar i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) nga dy shitblerje dhe dy veshmbathje: Na ka ndaluar nga shitblerja me të prekur dhe me të hedhur. Të prekurit (el mulamese) është të prekë një person rroben e një tjetri me dorën e tij, natën apo ditën dhe kjo prekje e detyron ta blejë atë, kurse të hedhurit (el munabedhe) është të hedhë një person rroben e tij tek një tjetër dhe ai tjetri të hedhë rroben e tij tek ky i pari, duke qenë kjo shitblerja e tyre pa marrë parasysh pranimin apo pëlqimin."18

### **Shitja e të voglit të të voglit të barsës.**

Ibnu Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë:

"Njerëzit në kohën e injorancës kryenin shitblerjen e mishit të të vegjëlve deri në të voglin e të voglit të barsës. I vogli i barsës është që të pjellë deveja dhe pastaj të mbarset i vogli i saj që ajo polli. I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i ndaloi ata nga kjo shitblerje."19

## Shitja me guraleca.

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë:

"I Dërguari i Allahut ka ndaluar nga shitja me guraleca dhe nga shitja e *gararit* (mosnjohjes së plotë të mallit)."20

Imam Neueuiu (Allahu e mëshiroftë!) në komentimin e "Sahihut të Muslimit" thotë:

"Përsa i përket shitjes me guraleca, ka tre mendime:

I pari: Kur shitësi thotë se: Të kam shitur ato rroba mbi të cilat do të bjenë këto gurë që do të hedh ose të kam shitur pjesën e tokës nga këtu e deri atje ku do të shkojë ky gurë.

I dyti: Kur shitësi thotë se: të kam shitur atë që do zgjedhësh deri sa të hedh gurin.

I treti: Kur hedhjen e gurit e quajnë shitje dhe kur thuhet se: nëse e godet këtë rrobë me gurë, atëherë e ke blerë me kaq lek."

---

17.Muslim (sahih).

18.Mutefekun alejhi.

19.Mutefekun alejhi.

20.Muslim, Tirmidhi, Ebu Daud, Ibnu Maxheh, Nesai (sahih).

---

## 2. Shitja e diçkaje që nuk e posedon në të vërtetë.

Hakim bin Hizam (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thotë: "I thashë të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): Nëse dikush më kërkon t'i shes diçka që nuk më ndodhet, a t'ja shes atij?" Ai tha:

"Mos e shit atë që nuk ndodhet tek ti!"21

## 3. Shitja e mallit që ke blerë para se ta marrësh në dorë.

Ibnu Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Kush blen një ushqim, mos ta shesë atë para se t'i dorëzohet në dorë!"

Ibnu Abasi thotë: "Dhe çdo gjë tjetër llogaritet si ushqimi."22

Transmeton Tausi nga Ibnu Abasi se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Kush blen një ushqim, mos ta shesë atë deri sa ta peshojë!"

I thashë Ibnu Abasit: "Përse kështu?" Ai tha: "A nuk i sheh disa që shesin e blejnë me ar (flori) kurse ushqimi vonohet?"<sup>23</sup>

#### 4. Shitja mbi shitjen e vëllait tënd (tregtarit tjetër).

Ibnu Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Askush prej jush mos të shesë mbi shitjen e vëllait të tij!<sup>24</sup> (duke i thënë blerësit që është te tregtari tjetër duke bërë pazar, hajde blije tek unë me kaq lek, më pak se sa i tha i pari).

#### 5. Shitja e Ijnes (me hile).

Kjo është ajo shitje e cila bëhet duke i shitur një mall dikujt dhe lekët i lë me të pritur deri në një afat të caktuar. Pastaj blerësi ia shet të njëjtin mall atij që ia bleu, por me lek në dorë dhe më pak se sa e bleu. Kjo është një lloj kamate me hile, sepse në fakt ai nuk donte mallin por lekët borxh.

Ibnu Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Në kohën kur të blini e shisni me hile (*ijneh*), të shkoni pas bishtit të lopës (pasurisë së kësaj bote), të pëlqeni të mbjellat dhe të lini xhihadin, atëherë Allahu do hedhë mbi ju përçmim e përulje dhe nuk do ta heqë atë prej jush deri sa t'i ktheheni fesë tuaj."<sup>25</sup>

---

21. Ibnu Maxheh, Tirmidhi, Ebu Daud (sahih).

22. Mutefekun alejhi.

23. Mutefekun alejhi.

24. Mutefekun alejhi.

25. Ebu Daud (sahih).

---

## 6. Shitja me afat duke rritur çmimin (shitja me këste).

Në këto kohë është përhapur shitja me afatizim dhe me rritje të çmimit origjinal të mallit, e cila njihet me emrin: shitja me këste. Siç është e njohur, kjo shitje bëhet duke shitur mallin me këste dhe duke shtuar në çmimin e tij kundrejt kohës së shtyrë, si p.sh: të jetë çmimi i mallit një mijë \$ dhe të shitet me këste një mijë e dyqind \$. Kjo lloj shitjeje është e ndaluar.

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Kush bën dy shitje në një shitje, ose ta prishë njëren, ose ka ngrënë kamatën."<sup>26</sup>

## Gjërat që nuk lejohen të shitet.

### 1. Alkooli.

Aishja (Allahu qoftë i kënaqur prej saj!) thotë: "Kur zbritën disa ajete nga fundi i sures Bekare, i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) doli dhe tha:

"U ndalua tregtia e alkoolit."<sup>27</sup>

### 2. E ngordhura, derri dhe idhujt.

Transmetohet nga Xhabir bin Abdullah se ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) në çlirimin e Mekës të thotë:

"Allahu dhe i Dërguari i Tij e ka bërë të ndaluar shitjen e alkoolit, të ngordhurën, derrin dhe idhujt." I thanë: "O i Dërguari i Allahut! Po dhjamin e të ngordhurës, sepse me të lyhen anijet, fërkohen lëkurat e kofshëve dhe e hanë njerëzit në mëngjes?" Ai tha:

"Jo, ai është i ndaluar" I Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) në atë çast shtoi: "Allahu i vraftë çifutët! Kur Allahu ua ndaloi atyre dhjamin e të ngordhurës, ata e zbukuruan atë e pastaj e shitën dhe hëngrën çmimin e tij!"<sup>28</sup>

---

26.Ebu Daud (hasen).

27.Mutefekun alejhi.

28.Mutefekun alejhi.

---

### 3. Qeni.

Transmetohet nga Ibnu Mesud el Ensari (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e ka bërë të ndaluar shitjen e qenit, të hollat e imorales dhe të fallxhorit."29

#### 4. Pikturat që përmbajnë gjëra me shpirt.

Seid bin ebi Hasen thotë: "Isha te Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) kur tek ai erdhi një burrë e i tha: "O Ibën Abas! Unë jam një njeri që e ha bukën me punën e duarve të mia dhe pikturoj këto piktura".

Ibën Abasi tha: Po të them ty vetëm atë që kam dëgjuar nga i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i cili ka thënë:

"Kush pikturon ndonjë pikturë, Allahu do ta dënojë atë deri sa t'i japë asaj shpirt dhe ai nuk do të mund t'i japë kurrë shpirt asaj."

Burri u mërzitë shumë, derisa iu zverdh fytyra. Atëherë Ibën Abasi i tha: "Nëse do patjetër të pikturosh, atëherë pikturo këto pemë dhe çdo gjë që nuk ka shpirt."30

#### 5. Frutat e pemëve para se të dalin kokrrat apo të piqen.

Enes ibën Maliku (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka ndaluar nga shitja e frutave të pemëve para se të piqen, si edhe nga shitja e hurmave (temër/hurmat arabe) para kohe. Dikush i tha: "Kur është koha e tyre?" Ai (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) tha: "Kur të skuqen apo të zverdhen."31

Gjithashtu Enesi transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka ndaluar nga shitja e pemëve para pjekjes. I thanë: "Kur piqen ato?" Tha: "Kur të skuqen". Pastaj tha: "Çfarë thoni nëse Allahu i ndalon frutat të dalin e të piqen, atëherë çfarë do t'i japë ai që ka marrë lekët e vëllait të tij?"32

#### 6. Të mbjellat para forcimit të kokrrës.

Ibën Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka ndaluar nga shitja e "temrit" para pjekjes dhe nga agrumet para se të focohet kokrra dhe të sigurohet se nuk është prekur me ndonjë sëmundje. Ka ndaluar edhe shitësin edhe blerësin."33

---

29.Mutefekun alejhi.

30.Mutefekun alejhi.

31.Buhariu.

32.Mutefekun alejhi.

## ZGJEDHJA

### Ç'është zgjedhja.

Zgjedhja është të kërkosh më të mirën për vete prej dy gjërave: ose të zgjedhësh plotësimin e aktit të shitblerjes (ta përfundosh atë), ose ta prishësh aktin dhe të tërhiqesh.

### Llojet e zgjedhjes.

#### 1. Zgjedhja në vend.

Kjo e drejtë për të zgjedhur është për të dyja palët, që nga fillimi i aktit deri sa të ndahen nga njëri-tjetri, me kusht që të mos kenë rënë në një mendje për rrëzimin e zgjedhjes (d.m.th. nëse vendosin kusht që në fillim që askush nuk ka të drejtë të tërhiqet nga akti edhe nëse vazhdojnë të jenë bashkë) ose ta rrëzojnë atë pas aktit apo ta rrëzojë vetëm njëri, atëherë rrëzohet e drejta e tij në zgjedhje dhe mbetet e drejta e tjetrit.

Ibnu Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Kur bëjnë akt shiblerjeje dy vetë, çdonjëri nga ata të dy ka të drejtën të zgjedhë deri sa të jenë bashkë dhe mos të jenë ndarë, apo njëri nga ata ta ketë lënë tjetrin për të zgjedhur. Nëse njëri ia lë në dorë tjetrit për të zgjedhur dhe pastaj bien në një mendje, atëherë është kryer akti i shitblerjes (dhe detyrohet blerësi të marrë mallin dhe shitësi vlerën). E nëse ndahen pas aktit por njëri nuk e ka mbaruar aktin, atëherë është kryer akti në çdo rast."<sup>34</sup>

- Është i ndaluar largimi nga vendi i aktit nga frika se pala tjetër ndërron mendje.

Transmeton Amër bin Shuajb nga babai i tij e ky nga gjyshi i tij se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Dy palët në tregti kanë të drejtën e zgjedhjes deri sa të ndahen, vetëm nëse kanë vënë ndonjë kusht zgjedhjeje. Nuk i lejohet askujt që të ndahet nga shoku i tij nga frika e kthimit nga ai akt."<sup>35</sup>



---

34.Mutefekun alejhi.

35.Ebu Daud, Tirmidhi, Nesai (sahih).

---

## 2. Zgjedhja e vënies së kushteve.

Kjo zgjedhje është që të vënë kusht të dyja palët ose njëra që të ketë të drejtën e zgjedhjes deri në një afat të caktuar, sado i gjatë qoftë ai. Ky akt dhe ky kusht është i saktë.

Ibnu Umer (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Dy palët në tregti kanë të drejtën e zgjedhjes deri sa të ndahen ose të jetë akti me kushte (të vëna nga të dyja palët ose njëra)."36

## 3. Zgjedhja në mallin me defekt.

Përmendëm më parë ndalimin e fshehjes së defektit të mallit, dhe nëse ndokush blen një mall me defekt, të cilin nuk e ka parë para se të ndaheshin nga akti, atëherë ai ka të drejtën e kthimit të mallit tek shitësi.

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Kush blen një dele të pamjelë (për shumë kohë që të duket sikur jep shumë qumësht) dhe e mjel atë, atëherë nëse e pëlqen ashtu le ta mbajë, nëse nuk e pëlqen atëherë ta kthejë tek i zoti dhe bashkë me të të japë një tas me hurma arabe (temër) për qumështin që i mori."37

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Nuk lejohet lënia e deles dhe devesë pa mjelë me qëllim që t'i fryhen gjitë. Nëse ndonjë e blen një të tillë, ai ka të drejtën e zgjedhjes pas mjeljes së saj; ose ta mbajë nëse do, ose ta kthejë bashkë me një tas hurma arabe (temër)."38

## KAMATA

### Ç'është kamata.

Kamata (apo fajdeja) është shtesa ose në origjinën e diçkaje, si në Fjalën e Allahut:

---

36.Muttefekun alejhi.

37.Muttefekun alejhi.

38.Buhariu, Ebu Daudi, Nesai.

---

**"...dhe e sheh tokën të vdekur por kur zbresim mbi të ujin tundet, shtohet dhe mbin në të prej çdo çifti bimësh"**<sup>39</sup>, ose shtesa në shkëmbim si në shkëmbimin e një dirhemi me dy dirhem.

### Gjykimi për kamatën.

Sipas Kuranit , Sunetit dhe Ixhmait kamata është e ndaluar

Allahu i Lartësuar thotë:

**"O ju që keni besuar! Kini frikë Allahun dhe largojuni asaj që ka ngelur prej ribasë (kamatës) nëse jeni besimtarë! Nëse nuk e bëni këtë, atëherë përgatituni për luftë nga Allahu dhe i Dërguari i Tij, e nëse pendoheni, atëherë merrni vetëm origjinën e të hollave tuaja! Kështu ju nuk i bëni padrejtësi askujt dhe nuk iu bëhet padrejtësi."**<sup>40</sup>

**"Ata që hanë kamatën nuk ngrihen vetëm si ngrihet ai që e ka prekur djalli."**<sup>41</sup>

**"Allahu e zhdruk kamatën<sup>42</sup> dhe e shton lëmoshën (ia shton atij që jep lëmoshë)."**<sup>43</sup>

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Largojuni shtatë shkatërruesëve!" Thanë: "Kush janë ato o i Dërguari i Allahut?"

Tha: "Vënia shok Allahut, magjia, vrasja e atij që ka ndaluar Allahu vetëm se me të drejtë, ngrënia e kamatës (fajdeve), ngrënia e pasurisë së jetimit, dezertimi kur je përballë armikut dhe shpifja ndaj besimtareve të pastërta e të pafajshme."<sup>44</sup>

Xhabiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë:

"I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e ka mallkuar ngrënësin e kamatës, dhënësin e saj, atë që e shkruan (në akt) dhe atë që dëshmon dhe ka thënë: "Ata janë njësoj."45

Ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

---

39.Suretu Haxh:5.

40.Bekare:278-279.

41.Bekare:275.

42.E zhdruk kamatën duke e hequr plotësisht nga dora e marrësit të saj ose ia bën të ndaluar (haram) begatinë e pasurisë së tij, madje ia heq atë në këtë botë dhe e dënon në botën tjetër.

43.Bekare:276.

44.Mutefekun alejhi.

45.Muslim.

---

"Kamata është shtatëdhjetë e tre llojesh. Më e lehta e tyre është njësoj sikur të martohet dikush me nënën e tij."46

Abdullah bin Handhale (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Një dirhem që ha dikush nga kamata, është më e rëndë se tridhjetë e gjashtë herë zina (imoralitet)."47

Ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Çdokush që vazhdon ta hajë kamatën, do të përfundojë në pakësim të pasurisë."48

## Llojet e kamatës.

Kamata është dy llojesh: "Nesieh" dhe "Fadl".

Kamata *nesieh* është shtesa e kushtëzuar, të cilën e merr borxhdhënësi prej borxhmarrësit kundrejt kohës së borxhit. Kjo lloj kamate është e ndaluar sipas Kuranit, Sunetit dhe Ixhmas.

Kamata e *fadlit* është shitja e të hollave me të holla, ose shitja e ushqimit me ushqim, duke shtuar në njërin krah (p.sh. të japësh 5 euro dhe të marrësh 6 euro, ose të japësh 1kg. oriz dhe të marrësh 2kg.) Kjo lloj kamate është e ndaluar sipas Sunetit dhe Ixhmas,

sepse ajo të shpie drejt llojit të parë të kamatës.

### **Gjërat në të cilat ndalohet kamata.**

Kamata ndalohet vetëm në gjashtë llojet, të cilat i ka përmendur hadithi i mëposhtëm:

Ubadetu bin Samit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Ari me ar, argjëndi me argjënd, gruri me grurë, elbi me elb, hurma arabe me hurma arabe (temër) dhe kripa me kripë (shkëmbehen) në të njëjtën sasi, në të njëjtën peshë, dorë më dorë. Nëse ndryshojnë këto lloje, atëherë shisni si të doni me kusht që të jetë dorë më dorë."<sup>49</sup>

Nëse shitet një nga këto lloje me të njëjtin lloj, si p.sh. ar me ar, apo hurmë arabe me hurmë arabe, atëherë është e ndaluar shtesa e njëjës anë dhe gjithashtu është i ndaluar edhe afati. Duhet patjetër që të jenë të njëjtë në

---

46.el Hakim (sahih).

47.Ahmedi (sahih).

48.Ibnu Maxheh (sahih).

49.Muslimi.

---

peshë e masë pa marrë parasysh cilësinë, si dhe duhet patjetër që të kryhet shkëmbimi i mallit dorë më dorë në vendin dhe çastin e aktit:

Ebu Seid el Hudrij (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Mos e shisni arin me ar, vetëm nëse janë të barabartë dhe mos shtoni në njëjën anë ...dhe mos i shisni ato një në dorë e një në mungesë!"<sup>50</sup>

Umer bin Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Ari me ar është kamatë, vetëm nëse shkëmbetet dorë më dorë, gruri me grur është kamatë, vetëm nëse shkëmbetet dorë më dorë, elbi me elb është kamatë, vetëm nëse shkëmbetet dorë më dorë, hurma arabe me hurmën arabe është kamatë, vetëm nëse shkëmbetet dorë më dorë."<sup>51</sup>

Ibën Seidi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thotë: "Në kohën e të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) na vinin hurma arabe të përzierë dhe shkëmbejm dy tasa me një. Kur e mori vesh i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) këtë gjë tha:

"Jo dy tasa hurme me një, as dy tasa grurë me një dhe as një dirhem me dy dirhem!"<sup>52</sup>

Nëse shitet një nga këto gjashtë lloje me lloj tjetër jo prej të njëjtit lloj si p.sh. të shkëmbesh ar me argjend, ose grur me elb, atëherë lejohet dallimi në peshë apo masë me kusht që të bëhet shkëmbimi i mallit në vend, ashtu siç thuhet në hadithin e lartëpërmendur të Ubades "Nëse ndryshojnë këto lloje, atëherë shisni si të doni, me kusht që të jetë dorë më dorë."<sup>53</sup>

Si dhe në hadithin e Ubades, i cili ndodhet tek Ebu Daudi e të tjerë, ku i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë:

"Nuk ka asnjë problem nëse shkëmbehet ari me argjend duke qenë se argjend ka më shumë, por dorë më dorë dhe jo për në një kohë të caktuar. Nuk ka asnjë problem nëse shkëmbehet gruri me elb duke qenë se elb ka më shumë, por dorë më dorë dhe jo për në një kohë të caktuar."<sup>54</sup>

---

50.Mutefekun alejhi.

51.Mutefekun alejhi.

52.Mutefekun alejhi.

53.Muslimi.

54.Ebu Daud (sahih).

---

Nëse shkëmbehet një prej këtyre gjashtë llojeve me një lloj tjetër të ndryshëm nga ai, si p.sh: ar me grurë, ose argjend me kripë, atëherë lejohet dallimi në masë e peshë si dhe afati i dorëzimit.

Aishja (Allahu qoftë i kënaqur prej saj!) transmeton se: "I Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) bleu ushqim (grurë) prej një çifuti për t'ia paguar pas një afati të caktuar dhe i la peng mburojën e tij të luftës."<sup>55</sup>

Emir Sanani thotë në librin "Subulus Selam":

"Dije se dijetarët kanë rënë dakord në lejimin e shkëmbimit të një lloji në të cilin rrjedh kamata me një lloj tjetër në të cilin rrjedh kamata, por të cilët nuk janë të të njëjtit lloj. Ky shkëmbim lejohet me afatizim apo me dallim në masë e peshë, siç është shkëmbimi i arit me grurë, argjendit me elb, etj."

Nuk u lejohet shkëmbimi i hurmave të njoma me të thata, përveç se të varfërve që nuk zotërojnë pemë hurme. Atyre u lejohet që të blejnë hurma të njoma (rutab) të marra prej pemës, me hurma të thata.

Abdullah bin Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se: "I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka ndaluar nga shitja me kile e frutave që janë në pemën e hurmës me hurma të thata, si dhe nga shitja me kile e rrushit të njomë me rrush të thatë."<sup>56</sup>

Zejd bin Thabit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se:

"I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka lehtësuar për të varfërit që kanë hurma të thata, t'i shkëmbejnë ato me hurma të njoma, duke i përcaktuar me mendje ata që kanë përvojë."<sup>57</sup>

Shkaku që i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka ndaluar nga shkëmbimi i hurmave të njoma me të thata është se të njomat nëse thahen, atëherë pakësohen:

Seid bin ebi Uekkasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thotë: U pyet i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) për shkëmbimin e hurmave të njoma me të thata dhe ai tha: "A pakësohen të njomat nëse thahen?" Thanë: "Po". Atëherë ndaloj nga kjo gjë."<sup>58</sup>

---

55.Buhariu.

56.Mutefekun alejhi.

57.Mutefekun alejhi.

58.Ebu Daud, Ibën Maxheh, Tirmidhi, Nesai (sahih).

---

## MARRËVESHJA NË KULTIVIMIN E TOKËS

### Ç'është marrëveshja në kultivim.

Në kuptimin gjuhësor është të kultivosh tokën dhe të marrësh një pjesë të fitimit.

Këtu është për qëllim me kultivimin, "el Muzareah": T'i japësh tokën dikujt për ta punuar e mbjellë, me kusht që fitimi të ndahet përgjysëm ose afër saj.

## Gjykimi për të

Transmeton Nafi se Abdullah bin Umer i ka thënë: "I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) bëri marrëveshje me çifutët e Hajberit që t'i japin atij gjysmën e prodhimeve bujqësore dhe të pemëve."<sup>59</sup>

Kajs bin Muslim transmeton nga Ebi Xhefer se ka thënë: "Të gjithë muhaxhirët në Medine kultivonin tokën dhe merrnin gjysmën e fitimit apo një të tretën e tij. Këtë e ka bërë edhe Aliu, Sead bin Malik, Abdullah bin Mesudi, Umer bin Abdulaziz, El Kasim, Urueh dhe familja e Ebu Bekrit, Umerit dhe e Aliut." Përmbledhi Buhariu

## Kujt i takojnë shpenzimet.

Nuk ka problem që shpenzimet e tokës t'i paguajë pronari i tokës ose punëtori, ose të dy së bashku.<sup>60</sup>

Buhariu thotë: "Umeri i merrte në punë njerëzit me kusht që nëse farën e sillte ai, atëherë do të marrë gjysmën e fitimit dhe nëse e sillnin ata, atëherë do të marrin qaq e aq." Buhariu thotë se: ka thënë Haseni (Allahu qoftë i kënaqur me të!) ka thënë: "Nuk ka problem që toka të jetë e njërit prej atyre dyve dhe shpenzimet e atë që del t'i ndajnë të dy".

---

59.Mutefekun alejhi.

60.Dhe sigurisht që fitimi do të ndahet pasi të jenë ndarë shpenzimet e tokës dhe t'i jenë dhënë atij që i ka shpenzuar.

---

## Çfarë nuk lejohet në këtë lloj tregtie.

Nuk lejohet kultivimi me kusht që një pjesë e tokës të jetë për pronarin dhe tjetra për punëtorin.

Gjithashtu, nuk lejohet për pronarin e tokës të thotë se unë do të marr nga fitimi një numër të caktuar kuintalësh.

Transmeton Handhaletu bin Kajs nga Rafi bin Hadixh se ka thënë: "Më kanë treguar dy xhaxhallarët e mi se ata punonin tokën në kohën e të Dërguarit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe merrnin prodhimin e anës së kanalit apo një pjesë të cilën ua ndante pronari. Atëherë i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i ndaloi nga kjo gjë". I thashë Rafiut: "Po nëse kjo bëhet me dinar e dirhem, a lejohet?" Tha: "Nuk ka problem të paguhen me dinar e dirhem (të holla)".

Lejthi ka thënë: "Ajo që ndalohej prej kësaj tregtie, ishte ajo në të cilën po të shihte ai që e kupton të lejuarën dhe të ndaluarën, nuk do ta lejonte atë., për shkak të rrezikshmërisë që ka (sepse nuk i dihet nëse do të ketë fitim apo jo, madje mund të ketë humbje nëse prodhimin e zë sëmundja apo ndonjë gjë tjetër)."61

Transmetohet gjithashtu, nga Handhale se ka thënë: "Pyeta Rafi bin Hadixh për të punuar në tokën e dikujt me të holla62 dhe më tha: "Nuk ka problem për këtë, ...nëse është diçka e ditur dhe e siguruar (për të cilën kanë rënë në një mendje), nuk ka problem në të."63

## MARRËVESHJA NË PËRKUJDESJEN E PEMËVE

### Ç'është marrëveshja në përkujdesjen e pemëve.

Ajo është të ngarkojë një pronar dikë që të kujdeset për një numër të caktuar të pemëve të tij, me kusht që t'i japë atij gjysmën e frutave apo afër gjysmës.

---

61.Buhariu, Nesai.

62.Siç ndodh përgjithësisht sot nëpër firmat, të cilat kanë blerë toka dhe punësojnë punëtorë me pagesë për mbjelljen dhe kultivimin e tyre.

63.Muslim, Ebu Daud, Nesai (sahih).

---

### Gjykimi për të:

Ibën Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i vuri kusht çifutëve të Hajberit që t'i paguajnë muslimanëve gjysmën e të korrave dhe gjysmën e frutave të pemëve."

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se ensarët i thanë të Dërguarit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): "Ndaji pemët e hurmave mes nesh dhe mes muhaxhirëve!" Ai tha: "Jo. Atëherë hiqni ju shpenzimet e shërbimit dhe i ndajmë frutat e tyre". Thanë: "Dëgjuam dhe u bindën."65



## NGJALLJA E TOKËS SË VDEKUR

### Ç'është toka e vdekur.

Toka e vdekur është ajo tokë e pabanuar (djerrë). Banimi është krahasuar me jetën, ndërsa djerra me vdekjen.

Ngjallja e tokës së vdekur është që të shkojë dikush te një copë tokë, të cilës nuk i njihet ndonjë pronar dhe ta ngjallë atë me pastrim, mbjellje, vaditje apo ndërtim, duke e bërë kështu pronë të tij.

### Nxitja e Islamit për ngjalljen e tokave.

Aishja (Allahu qoftë i kënaqur prej saj!) transmeton se i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Kush ngjall një tokë e cila nuk i përket askujt, atëherë ajo bëhet pronë e tij."<sup>66</sup>

Urvatu thotë: "Kështu gjykoi Umeri në kohën e hilafetit të tij".

Xhabiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Kush ngjall një tokë të vdekur, ajo është e tij."<sup>67</sup>

Transmeton gjithashtu, Xhabiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Kush e rrethon një tokë (me gardh a diçka tjetër), ajo është e tij."<sup>68</sup>

---

66.Mutefekun alejhi.

67.Mutefekun alejhi.

68.Buhariu.

69.Tirmidhiu (sahih).

---

## QIRAJA

### Ç'është qiraja.

Qiraja është sundimi i dobisë (p.sh: strehimi është dobia e banesës) së diçkaje kudrejt një pagese.

### Gjykimi për qiranë:

Allahu i Lartësuar thotë:

**"Nëse ato i japin qumësht fëmijëve tuaj, atëherë jepuni atyre shpërblimin (qiranë) e tyre."**<sup>69</sup>

**"Njëra prej atyre dyjave tha: "O babai ynë! Punësoje atë me qira, sepse ai është më i miri që ke punësuar, është i fortë dhe besnik."**<sup>70</sup>

"Ata gjetën aty një mur që donte të rrëzohej dhe ai e ngriti atë. Shoku i tij i tha (Musai i tha Hidrit): "Nëse do, mund të merrje shpërblim për të."<sup>71</sup>

Aishja (Allahu qoftë i kënaqur prej saj!) transmeton se i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe Ebu Bekri morën me qira një burrë prej fisit dejl pastaj një prej fisit Abd bin Udej, të cilët ishin udhëzues dhe njohës të mirë të shtegjeve (kjo ka qenë në hixhran e të Dërguarit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të! për në Medine)."<sup>72</sup>

---

69.Ebu Daud (sahih).

70.Talak:6.

71.Kasas:26.

72.Kehf:77.

---

### Gjërat në të cilat lejohet qiraja.

Çdo gjë prej së cilës ka dobi dhe struktura e saj qëndron e pa prekur, lejohet qiraja nëse nuk ka ndonjë pengesë nga sheriati në lidhje me të.

Është kusht që gjëja e marrë me qira të jetë e njohur, gjithashtu vlera e qirasë të jetë e njohur, koha e qirasë dhe lloji i punës.

Allahu i Lartësuar tregon për të moshuarin e Medjenit kur i tha Musait (Paqja e Allahut qoftë mbi të!):

**"Unë dëshiroj të të jap një rën nga dy bijat e mia (për martesë) dhe (mehri i tyre është) të më shërbesh tetë vjet, nëse i plotëson dhjetë, atëherë do të të isha mirënjohës."**<sup>73</sup>

Transmetohet nga Handhale bin Kajs se ka thënë: "Pyeta Rafi bin Hadixh për të punuar në tokën e dikujt me të holla<sup>74</sup> dhe më tha: "Nuk ka problem për këtë, ...nëse është diçka e ditur dhe e siguruar, nuk ka problem në të."<sup>75</sup>

### **Qiraja (paga) e punëtorit.**

Ibën Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Jepjani hakun punëtorit para se t'i thahet djersa!"<sup>76</sup>

### **Gjynahu i atij që nuk ia jep hakun punëtorit.**

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Allahu i Lartësuar thotë: "Unë jam armik i tre personave në Ditën e Kiametit: një personi që jep për hirin Tim pastaj tradhëton; një personi që shet një njeri të lirë dhe e ha çmimin e tij, dhe një personi që merr në punë një punëtor dhe pasi ai ia kryen punën, ky nuk ia jep të drejtën (hakun) e tij."<sup>77</sup>

### **Gjërat në të cilat nuk lejohet qiraja.**

Allahu i Lartësuar thotë:

**"Dhe mos i detyroni robëreshat për prostitucion nëse ato dëshirojnë dliresinë, me qëllim që të përfitoni diçka nga pasuritë e kësaj bote.**

---

73.Kasas:27.

74.Siç ndodh përgjithësisht sot nëpër firmat të cilat kanë blerë toka dhe punësojnë punëtorë me pagesë për mbjelljen dhe kultivimin e tyre

75.Muslim, Ebu Daud, Nesai.

76.Ibën Maxhe (sahih).

77.Buhariu (hasen).

---

**Por nëse ndonjë i detyron ato, atëherë Allahu pas një detyrimi të tillë është Falës i Madh, Mëshirëplotë."78**

Xhabiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se një robëreshë e Abdullah bin Ubej bin Selul (koka e munafikëve) që quhej Mesikeh dhe një tjetër që quhej Emimeh, detyroheshin nga ai për prostitucion dhe ato u ankuan tek i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Atëherë Allahu zbriti Fjalën e Tij: **"Mos i detyroni robëreshat për prostitucion..."** deri në Fjalën e Tij: **"Allahu është Falës i Madh, Mëshirëplotë."79**

Ebu Mesud el Ensari (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e ka bërë haram çmimin e qenit, paratë e prostitucionit dhe qiranë e fallxhorit."80

**Qiraja në leximin e Kuranit.**

Abdurrahman bin Shibël el Ensari thotë: "Kam dëgjuar të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) të thotë:

"Lexoni Kuran dhe mos u ushqeni me të. Mos shtoni pasurinë me të, mos e harroni atë (duke ndenjgur gjatë pa lexuar) dhe mos e teproni në të (duke zbukuruar zërin së tepërmi)!"81

Xhabir bin Abdullah thotë: "I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) doli tek ne, ishim duke lexuar Kuran e në mesin tonë ndodheshin beduinë dhe joarabë. Ai tha:

"Lexoni, se leximi juaj është i saktë! Do të vijnë pas jush njerëz që do ta teprojnë në leximin e tij (duke zbukuruar zërin dhe duke u përpjekur që të nxjerrin shkronjat në një mënyrë të tepruar, me qëllim që të mburren e të bëhen të njohur), do të kërkojnë shpërblimin e tij shpejt dhe nuk do ta vonojnë atë (do të kërkojnë shpërblimin (qiranë) e leximit në këtë botë dhe do t'i japin përparësi mbi shpërblimin e botës tjetër)."82

Ebu Seid el Hudri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) të thotë:

---

78.Nur:33.

79.Muslim (sahih).

80.Mutefekun alejhi.

81.Ahmed (sahih).

82.Ebu Daud (sahih).

---

"Mësojeni Kuranin dhe kërkojini Allahut me të xhenetin para se ta mësojnë atë njerëz që kërkojnë me të (mësimin e tij) dunjanë! Kuranin e mësojnë tre persona: një person që mburret me të (për të fituar emër), një që ushqehet me të dhe një që e lexon atë për Hir të Allahut."<sup>83</sup>

## SHOQËRITË TREGTARE

### Ç'është shoqëria tregtare.

Shoqëria tregtare është një marrëveshje e cila bëhet ndërmjet dy personave apo më shumë, që të bashkohen me qëllim që të arrijnë të fitojnë në tregti. Kjo shoqëri mund të ndodhë edhe pa ndonjë marrëveshje, siç është rasti me trashëgiminë.

### Gjykimi për shoqërinë tregtare.

Allahu i Lartësuar thotë:

**"Dhe me të vërtetë, shumë bashkëpjesëtarë i bëjnë padrejtësi njëri-tjetrit përveç atyre të cilët besojnë dhe punojnë mirësi e drejtësi. E sa pak janë këta!"<sup>84</sup>**

"Nëse ndonjë burrë apo grua nuk lë pas as paraardhës, por ka vëlla ose motër, secili prej tyre merr një të gjashtën (e trashëgimisë. Por nëse lë më shumë se dy, atëherë ata janë pjesëmarrës (ortakë) në një të tretën e trashëgimisë."<sup>85</sup>

Es Saib (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i ka thënë të Dërguarit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): "Ke pas qenë ortakë im në kohën e injorancës dhe ishe ortakë më i mirë (që gjendej)..."<sup>86</sup>

---

83.Ibën Nasër (sahih).

84.Suretu Sad:24.

85.Suretu Nisa:12. Ajeti është argument për pohimin e ortakësisë dhe shoqërive të ndryshme përgjithësisht.

86.Ibën Maxheh (sahih).

---

## Shoqëria tregtare sipas sheriatit.

Imam Sheukani në "Sejli el xhirar", vëll. III, f. 246-248 thotë:

"Shoqëria e rregullt në sheriat është ajo shoqëri që gjendet si rrjedhojë e pëlqimit të dy palëve apo më shumë, në mënyrë që çdonjëri prej tyre të fusë një sasi të caktuar të hollash dhe pastaj t'i fusin ato në tregti, me qëllim që të arrijnë të fitojnë dhe në fund ta ndajnë fitimin, në atë mënyrë që secili të marrë në raport me të hollat që futi në atë aktivitet biznesi. Nëse ata bienë dakord që ta ndajnë fitimin në mënyrë të barabartë pa marrë parasysh se nga sa lekë kanë futur, atëherë kjo është e lejuar, meqë ata e kanë pëlqyer një gjë të tillë qoftë edhe sikur të jetë pasuria që ka futur ndonjëri prej tyre shumë e vogël dhe pasuria e tjetrit e madhe. Nuk ka problem në sheriat për një gjë të tillë, përderisa ajo tregti të jetë me pëlqimin e të gjithë ortakëve dhe me dëshirën e tyre".

## AZHIOTAZHI (EL MUDARABE)

### Ç'është azhiotazhi.

Azhiotazhi (el mudarabe) është marrë nga udhëtimi nëpër tokë, që do të thotë udhëtim me qëllim tregtie.

Allahu i Lartësuar thotë:

**"...Dhe të tjerë udhëtojnë nëpër tokë duke kërkuar begatitë e Allahut..."<sup>87</sup>**

Në arabisht quhet *Kirad* (ndarje, shkëputje), sepse i zoti i pasurisë ndan një pjesë të pasurisë së tij për ta futur në tregti, si dhe një pjesë të fitimit me ortakun që bëri tregti me pasurinë e tij.

Me azhiotazhin këtu është për qëllim: "Marrëveshja ndërmjet dy palëve për të paguar njëra palë shumën që duhet për aktivitetin e caktuar palës tjetër, e cila do t'i punojë ato në atë aktivitet dhe fitimin do ta ndajnë sipas asaj që bien në një mendje që në fillim (njëra palë ka të hollat kurse tjetra përvojën dhe mundimin)"

## Gjykimi për azhiotazhin.

Ibën Mundhir (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thotë në librin tij "el Mexhmu", f.124:

"Dijetarët janë bashkuar në mendimin se azhiotazhi me ar e argjend (të holla, para) është i lejuar. Janë bashkuar, gjithashtu, edhe në fjalën se punëtori ka të drejtë t'i vendosë kusht financuesit për të marrë një të tretën e fitimit, gjysmën e tij ose aq sa bien në një mendje që në fillim të marrëveshjes, me kusht që të jetë e ditur nga të dyja palët që në fillim."

Edhe shokët e të Dërguarit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) kanë punuar me azhiotazh.

Zejd ibën Eslem transmeton nga babai i tij se ka thënë: Abdullahi dhe Ubejdilahi, dy bijtë e Umer bin Hatabit (Allahu qoftë i kënaqur me të!), dolën me një ushtri për në Irak. Kur mbërritën, kaluan nga Ebu Musa el Eshari i cili ishte kryetar i Basras. Ai u uroi mirëseardhjen dhe pastaj u tha: "Nëse do të mund të bëja diçka për ju, do ta bëja. Ah, po, këtu kam prej pasurisë së Allahut (të hollat e zekatit të banorëve të Basras), të cilën desha t'ia dërgoj prijësit të besimtarëve. Unë po ua jap juve që të bleni prej mallit të Irakut dhe pastaj ta shisni në Medine. Pasi ta shisni mallin, jepini origjinën e të hollave prijësit të besimtarëve, ndërsa fitimin e keni ju të dy". Ata thanë: "Do ta donim një gjë të tillë. Ashtu bëri dhe i shkroi Umer bin Hatabit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) që të marrë të hollat (e zekatit) prej tyre. Pasi erdhën në Medine dhe fituan prej tregtisë, shkuan tek Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) për të paguar lekët e zekatit që u dha Ebu Musa.

-A i dha të gjithë ushtrisë kështu si juve? – pyeti Umeri.

-Jo.

-Domethënë ju dha meqë jeni bijtë e prijësit të besimtarëve! Dorëzoheni pasurinë e zekatit bashkë me fitimin!

Abdullahi nuk foli, kurse Ubejdilahi tha: "Nuk duhet ta bësh këtë, o prijësi i besimtarëve, sepse nëse kjo pasuri do të ishte pakësuar në tregti apo do të kishte humbur e gjitha, atëherë ne do ta kompensonim atë!

-Dorëzoheni! – tha Umeri.

Abdullahi përsëri heshti, kurse Ubejdilahi tha të njëjtën gjë.

Atëherë dikush prej të pranishmëve tek Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tha:

-O prijësi i besimtarëve! Përse nuk e llogarit si azhiotazh?

-Si të tillë po e llogaris. Atëherë Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) mori origjinën e pasurisë (të hollat e zekatit) dhe gjysmën e të gjithë fitimit (për t'i vënë në arkën e pasurisë së muslimanëve) ndërsa Abdullahi me Ubejdilahin, dy bijtë e Umer bin Hatabit, morën gjysmën tjetër të fitimit."<sup>88</sup>

## Besnikëria e punëtorit.

Azhiotazhi është i lejuar në çdo formë, qoftë i kufizuar (nga i pasuri, si p.sh. të thotë që bëj këtë lloj tregtie apo mos e ngarko mallin në anije etj.) apo i pakufizuar (si p.sh.: të thotë që bëj çdo lloj tregtie që do) dhe punëtori nuk kompenson asgjë vetëm në rast se e prish diçka me dashje apo duke bërë diçka që ia ka ndaluar i zoti i pasurisë.

Ibën Mundhiri thotë: "Dijetarët janë bashkuar në mendimin se nëse i zoti i pasurisë e ndalon punëtorin të shesë mall pa lekë në dorë dhe ai shet, atëherë punëtori duhet ta kompesojë atë (nëse nuk ia kthejnë borxhin)".

Hakim ibën Hizami (Allahu qoftë i kënaqur me të!), shok i të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) kur i jepte dikujt pasuri me qëllim azhiotazhi, i vendoste kusht që mos ta fuste atë para në mëlçi të njoma (ushqime që prishen), mos të kalonte me të detin dhe mos të kalonte nëpër barqet e luginave. Nëse bën ndonjë prej këtyre, atëherë do të kompensosh mallin tim."<sup>89</sup>

## PARAPAGIMI

### Ç'është parapagimi (es selem).

Es Selem është shitja e diçkaje të përshkruar e të përcaktuar, e cila nuk është present, por që pritët të vijë duke paguar çmimin para dorëzimit të mallit.

### Gjykimi për të:

Allahu i Lartësuar thotë:

---

88.Malik, Bejhaki (sahih).

89.Darakutni, Bejhaki (sahih).

---

**"O ju që keni besuar! Kur të lidheni për një borxh për një kohë të caktuar, shkruajeni atë!"<sup>90</sup>**

Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thotë: "Betohem se parapagimin e siguruar për në një kohë të caktuar, Allahu e ka bërë të lejuar në Librin e Tij. Pastaj lexoi ajetin e mësipërm."<sup>91</sup>



Gjithashtu, ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thotë:

"Kur i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) erdhi në Medine, ata shisnin hurmat me paradhënie dy apo tre vjet para. Ai (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) tha:

"Kush parapaguan për diçka, atëherë të jetë pesha e caktuar, masa e caktuar dhe koha e caktuar!"<sup>92</sup>

### **Parapagimi atij që nuk e posedon bazën e mallit (farën).**

Nuk është kusht në *es selem* që i parapaguari për një mall të caktuar ta posedojë atë në çast.

Muhamed ibën ebi Muxhahid thotë: "Më dërgoi Abdullah ibën Shidad dhe Ebu Burde tek Abdullah ibën ebi Auf (Allahu qoftë i kënaqur me të!) dhe më thanë: "Pyete atë nëse parapaguanin shokët e të Dërguarit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) në kohën e tij për grurin? Abdullahi tha: "Parapaguanim fise të Shamit për grur, elb dhe vaj, për sasi të caktuar dhe kohë të caktuar." I thashë: "A i paguanit vetëm atij që e kishte farën?" Tha: "Nuk pyesnim fare për këtë gjë. Pastaj më dërguan te Abdurrahman ibën Ebza dhe pasi e pyeta më tha: "Shokët e të Dërguarit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) parapaguanin në kohën e tij dhe nuk i pyesnim nëse kishin farë apo jo."<sup>93</sup>

## **BORXHI**

### **Dobia e borxhit.**

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Kush i heq muslimanit një ankth e brengë në këtë botë, atij Allahu do t'i heqë një nga ankthet e Ditës së Gjykimit; kush ia lehtëson atij që është ngusht (duke ia falur borxhin ose duke ia larë atë, apo duke ia

---

91.Bekare:282.

92.Hakimi, Bejhaki (sahih).

93.Mutefekun alejhi.

94.Buhariu, Ebu Daudi, Nesai, ibën Maxheh.

---

shtyrë afatin), Allahu do t'ja lehtësojë atij në dynja dhe ahiret. Allahu është në ndihmën e robit të Tij derisa ai të jetë në ndihmën e vëllait të tij."94.

Ibën Mesudi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Çdo musliman që i jep borxh vëllait të tij dy herë, i shkruhet sikur ka dhënë sadaka sa vlera e njëres herë."95

### **Shtrengimi në borxh.**

Theubani, shërbëtori i të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Atij që i ndahet shpirti nga trupi dhe është i pastër nga tre gjëra, do të hyjë në xhenet: nga mendjemadhësia, fshehja e plaçkës së luftës, dhe borxhi."96

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Shpirti i besimtarit qëndron i lidhur me borxhin e tij, deri sa t'i shlyhet."97

Ibën Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Kush vdes duke pasur borxh një dinar apo një dirhem, do t'i shlyhet nga punët e tij të mira. Nuk do të ketë atje as dinar, as dirhem."98

Transmeton Ebu Katade (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) u ngrit dhe foli. U përmendi atyre se xhihadit në Rrugën e Allahut dhe besimi në Allahun, janë punët më të mira. Një burrë u ngrit dhe tha: "O i Dërguari i Allahut! Nëse unë vritem në Rrugën e Allahut, a më fshihen gjynahet? I Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i tha atij: "Po, nëse ti vritesh në Rrugën e Allahut, duke duruar dhe kërkuar shpërblimin e Allahut, në ballë dhe jo në shpinë (nuk ke qenë duke dezertuar dhe kthyer shpinën armikut)." Pastaj tha i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): "Si the?" Tha: "Thashë se nëse

---

95.Muslim, Tirmidhi, Ebu Daud (sahih).

96.Ibën Maxheh (hasen).

97.Ibën Maxheh, Tirmidhi (sahih).

98.Tirmidhi (sahih).

99.Ibën Maxheh (sahih).

vritem në Rrugën e Allahut, a më fshihen gjynahet?" I Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) tha: "Po, nëse vritesh në Rrugë të Allahut duke qenë se ke duruar dhe ke kërkuar shpërblimin nga Allahu, në ballë dhe jo në shpinë, përveç borxhit (d.m.th. borxhi nuk të falet). Xhibrili ma tha këtë gjë (tani)."99

### **Ai që merr të hollat e njerëzve duke pasur për qëllim t'i kthejë ato apo t'i prishë.**

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Ai që merr të hollat e njerëzve dhe ka për qëllim që t'i kthejë ato, Allahu ia shleftë ato (e ndihmoftë në kthimin e borxhit). Ai që i merr duke pasur për qëllim shpërdorimin e tyre, Allahu e shpërdoroftë atë!"100

Shuajb ibën Amër thotë: "Na ka treguar Suhejb el Hajër se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Ai burrë që merr një borxh dhe ka për qëllim që mos ta kthejë atë, do ta takojë Allahun duke qenë hajdut."101

### **Urdhëri për shlyerjen e borxhit.**

Allahu i Lartësuar thotë:

"Sigurisht që, Allahu ju urdhëron t'ua ktheni prapë atyre që u takojnë gjërat e dhëna juve amanet për ruajtje në besim dhe që kur të gjykoni mes njerëzve, të gjykoni me drejtësi. Vërtet sa i shkëlqyer është mesimi që Allahu jua jep juve! Vërtet Allahu është gjithnjë Gjithëdhëgues, Gjithëshikues."102

### **Mirësjellja në kërkimin e kthimit të borxhit.**

Ibën Umeri dhe Aishja (Allahu qoftë i kënaqur me të dy ata!) transmetojnë se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Kush kërkon një të drejtë të tij (borxhin), ta kërkojë atë me butësi..."<sup>103</sup>

---

99.Muslim, Tirmidhi, Nesai (sahih).

100.Buhariu.

101.Ibën Maxheh (hasen sahih).

102.Nisa:58.

103.Ibën Maxheh (sahih).

---

## Shtyrja e afatit të personit që ndodhet ekonomikisht keq

Allahu i Lartësuar thotë:

**"Në qoftë se borxhliu është në vështirësi, atëherë i lini kohë atij derisa t'i lehtësohet mundësia për t'i kthyer detyrimet, por nëse ju ia falni në shenjë mirësie, kjo është shumë më mirë për ju, vetëm sikur ta dinit."**<sup>104</sup>

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Një njeri gjithmonë u jepte borxh njerëzve dhe i thoshte shërbyesit të tij sa herë që e çonte për këtë punë te njerëzit: "Nëse borxhliu është i varfër, falja atij, që kështu të mund të na falë Allahu neve." Kështu, kur ai shkoi tek Allahu (ndërroi jetë), Allahu e fali atë."<sup>105</sup>

Ebu el Jusr (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Kush dëshiron që Allahu ta fusë në Hijen e Tij (në Ditën e Kiametit), atëherë le t'ia shtyjë afatin borxhliut i cili është ngushtë ose t'ia falë borxhin atij!"<sup>106</sup>

## Mosshlyrja e borxhit nga ai që ka mundësi, është padrejtësi.

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Shtyrja e shlyerjes së borxhit nga ai që ka mundësi, është padrejtësi."<sup>107</sup>

## Izolimi i atij që ka mundësi të shlyejë borxhin dhe nuk e shlyen

Transmeton Amër bin Sherijd nga babai i tij se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Shtyrja e shlyerjes së borxhit nga ai që ka mundësi, e bën të lejuar hapjen e fjalës se ai ka bërë padrejtësi dhe dënimin e tij me izolim e kërcënim."**108**

## Çdo borxh që sjell fitim është kamatë.

Ebu Burdeh thotë: "Shkova në Medine dhe takova Abdullah bin Selam. Ai më tha: "Eja me mua në shtëpinë time që të të jap të pish me kupën në të cilën ka pirë i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!)

---

104.Bekare:280.

105.Buhariu.

106.Ibën Maxheh (sahih).

107.Mutefekun alejhi.

108.Nesai, Ibën Maxheh, Ebu Daud (hasen).

---

dhe të sjellë bashkë me të një sasi në të cilën ka një dhuratë. Ruaju asaj sasi dhe asaj që ka në të!"**109** dhe të falesh në një xhami në të cilën ai është falur". Shkova me të dhe më dha të pija dhe hurma për të ngrënë, pastaj u fala në xhaminë e tij. Më tha: "Ti je në një tokë, në të cilën është shfaqur kamata. Prej llojeve të kamatës është që njëri prej jush të marrë borxh për një afat të caktuar dhe kur të vijë afati të shlyejë borxhin

**kthehu lart**

## PENGU

### Ç'është pengu?

Pengu në kuptimin gjuhësor është izolimi.

Allahu i Madhëruar thotë:

"Secili është peng për atë që ai ka fituar."**110**

Në kuptimin legjislativ, pengu është të lësh një plaçkë (peng) të lidhur me borxhin, në mënyrë që borxhdhënësi të marrë prej asaj plaçkeje të drejtën (hakun) e tij, nëse borxhliu nuk e shlyen dot borxhin.

## Gjykimi për pengun

Allahu i Lartësuar thotë:

**"Dhe nëse jeni në udhëtim dhe nuk mundeni të gjeni dot shkrues (të borxhit), atëherë merrni ose lini peng diçka!"<sup>111</sup>**

---

109.Buhariu, Bejhakiu (sahih).

110.Mudethir:38.

111.Bekare:283.

---

Përkufizimi i lënies së pengut me udhëtimin në këtë ajet është përmendur se në udhëtim ndodh më shpesh kjo gjë, por kjo nuk do të thotë që në raste normale dhe joudhëtimi, kjo gjë (pengu) të jetë e ndaluar, sepse hadithet e të Dërguarit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) tregojnë lejueshmërinë e saj.

Tregon Aishja (Allahu qoftë i kënaqur prej saj!) se:

"I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) bleu ca drithë te një çifut, me qëllim që t'ja paguajë në një afat të caktuar dhe i la atij peng mburojën e tij të luftës."<sup>112</sup>

## A lejohet përdorimi i pengut.

Nuk i lejohet atij që e merr pengun ta përdorë dhe të përfitojë prej tij, për arsyen që thamë tek borxhi: çdo borxh që sjell fitim është kamatë.

Në rast se pengu është kafshë ngarkese apo kafshë që i merret qumështi, atëherë i lejohet pengmbajtësit që t'i hipë asaj apo ta mjelë atë, nëse ai i ushqen ato.

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Kafsha e ngarkesës mund të përdoret për t'i hipur nëse është lënë peng dhe nëse shpenzohet për të. Qumështi i kafshës mund të pihet nëse është lënë peng dhe nëse shpenzohet për të. Ai që i hipën asaj apo i merr qumështin ka për detyrë ta ushqejë

atë."113

## TRANSFERIMI I PARAVE

### Ç'është transferimi i parave.

Transferimi i parave është kalimi i borxhit prej dikujt tek dikush tjetër.

Nëse dikush i ka marrë dikujt para borxh dhe atij i ka marrë borxh një i tretë, e ky e transferon borxhin që i ka dhënë të tretit tek i pari (d.m.th. që borxhin që i ka marrë këtij ai i tretë mos t'ia kthejë këtij, por atij të parit që

---

112.Mutefekun alejhi.

113.Buhariu, Ebu Daudi, Tirmidhiu, ibën Maxheh.

---

ky i ka marrë borxh), atëherë borxhdhënësi i parë ka për detyrë që t'i drejtohet borxhliut të tretë, nëse ai ka mundësi ta shlyejë borxhin.

I Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë:

"Shtyrja e kthimit të borxhit nga ai që ka mundësi është padrejtësi dhe nëse ndokush nga ju transferohet tek ndonjë që ka mundësi financiare, atëherë le të transferohet!"114

## DEPOZITIMI (AMANETI)

### Ç'është depozitimi?

Depozitimi apo amaneti është lënia e diçkaje për ta ruajtur tek dikush tjetër.

### Gjykimi për të.

Nëse dikush i lë vëllait të tij për të ruajtur një plaçkë (amanet), atëherë është e pëlqyeshme që ai ta pranojë atë nëse është i sigurt te vetja se mund ta ruajë atë amanet.

Shkaku i të qënurit e pëlqyeshme pranimit të amanetit, është duke u nisur nga rregulli i ndihmës së njëri-tjetrit në punë të mira e të devotshme.

Është detyrë për mbajtësin e amanetit që t'ja kthejë atë të zotit të tij, kur ai ta kërkojë atë.

Allahu i Lartësuar thotë:

**"Sigurisht që Allahu ju urdhëron që t'jua ktheni prapë atyre që u takojnë gjërat e dhëna juve amanet për ruajtje në besim."**<sup>115</sup>

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë:

"Ktheja amanetin atij që ta ka lënë atë në besim!"<sup>116</sup>

### **Kompensimi i amanetit nëse priset në dorën e mbajtësit.**

Nuk kompenson gjë mbajtësi i amanetit vetëm në rast se nuk kujdeset ashtu siç duhet për të.

Tregon Amër bin Shuaib nga babai i tij, e ky nga gjyshi i tij se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

---

114.Ibën Maxheh, Ahmed (sahih).

115.Nisa:58.

116.Tirmidhiu, Ebu Daudi (sahih).

---

"Atij që i lihet një amanet, nuk kompenson gjë nëse ai priset tek ai."<sup>117</sup>

Tregon gjithashtu (Amri) se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Nuk ka kompensim mbi atë që i është besuar diçka."

Enes bin Malik (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se Umer bin Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) i ngarkoi atij që të kompensonte një plaçkë që u vodh dhe që i ishte lënë atij amanet."

Bejhakiu thotë: "Kjo ka ndodhur se ai nuk është kujdesur për të ashtu siç duhet, kështu që e kompensoi atë për shkak të moskujdesit"<sup>119</sup>.



## HUADHËNIA

### Ç'është huadhënia?

Dijetarët e fikhut thonë se huadhënia është lejimi që bën i zoti i një plaçke një tjetri, për të përdorur plaçkën e tij pa paguar gjë kundrejt atij përdorimi.

### Gjykimi për të.

Të japësh hua është diçka e pëlqyer duke u nisur nga Fjala e Allahut të Lartësuar.

**"Ndhimoheni njëri-tjetrin në punë të mira e të devotshme!"<sup>120</sup>**

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë:

"Allahu është në ndihmë të robit, deri sa të jetë ai në ndihmë të vëllait të tij."<sup>121</sup>

Allahu i Lartësuar ka folur ashpër për ata që nuk japin hua.

117.Ibën Maxheh (hasen).

118.Darakutni, Bejhakiu (hasen).

119.Bejhakiu:vëll. VI, f.289.

120.Maide:2.

121.Tirmidhiu, Ibën Maxheh (sahih).

**"Mjerë për ata që falen (për sy e faqe), të cilët janë të pakujdesshëm për namazin e tyre. Ata të cilët bëjnë vepra të mira vetëm për t'u dukur në sy të njerëzve dhe ata të cilët nuk japin as hua (fqinjtit)."<sup>122</sup>**

### Urdhri për kthimin e huasë.

Allahu i Lartësuar thotë:

**"Sigurisht që, Allahu ju urdhëron që t'jua ktheni prapë atyre që u takojnë gjërat e dhëna juve amanet për ruajtje në besim."<sup>123</sup>**

## Kompensimi i saj nëse prishet.

Huamarrësi është i besueshëm dhe nuk e kompenson huanë e prishur, vetëm nëse nuk kujdeset për të ose i vë kusht huadhënësi që nëse e prish plaçkën, atëherë do ta kompensojë.

Tregon Safuan bin Jala se babai i tij ka thënë: "Më ka thënë i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!):

"Kur të të vijnë të dërguarit e mi, jepu atyre tridhjetë mburoja (luftë) dhe tridhjetë deve."

Thashë: "O i Dërguari i Allahut! A t'jua jap si hua të garantuar apo për të më kthyer të njëjtën plaçkë? Tha: "Për të të kthyer të njëjtën plaçkë."<sup>124</sup>

Thotë Emir es Saneani në librin "Subulus Selam": vëll. III. f.69

"Huaja e garantuar është ajo e cila kompensohet me vlerën e saj nëse prishet, ndërsa huaja e cila duhet kthyer po e njëjta, është ajo që nuk kompensohet me vlerë. Dhe hadithi është argument për moskompensimin e huasë, vetëm në rast kushtëzimi."

---

122.Maun:4 - 7.

123.Nisa:58.

124.Ebu Daud (sahih).

---

## GJËJA E GJETUR

### Ç'është gjëja e gjetur?

E gjetura është çdo lloj pasurie që respektohet nga sheriatu (që është e lejuar), e cila gjendet e humbur dhe nuk i dihet pronari.

### Detyra e atij që gjen diçka të humbur.

Kush gjen të holla që i kanë humbur dikujt, ka për detyrë të mësojë llojin dhe sasinë e tyre, pastaj të marrë një besimtar të drejtë për të dëshmuar dhe t'i ruajë ato si dhe të pyesë se kujt i kanë humbur për një vit rresht. Nëse dikush vjen dhe pasi e provon për shenjat dhe vërteton se janë të atij, atëherë ia dorëzon ato të zotit, qoftë edhe pas një viti, në të kundërt, nëse nuk i del i zoti, atëherë i lejohet t'i përdorë ato për vete.

Suejd bin Gafle thotë: "Takova Ubej bin Keab dhe më tha: "Gjeta një qese me njëqind dinarë në të dhe shkova të pyesja të Dërguarin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) se ç'të bëja me to? Ai tha: "Pyet për të një vit rresht!"

Pyeta një vit dhe nuk e gjeta të zotin e saj, pastaj shkova tek i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe ai më tha: "Pyet për të edhe një vit tjetër!"

Pyeta edhe një vit tjetër, por përsëri nuk e gjeta pronarin e saj, kështu që, shkova te i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) për të tretën herë dhe ai më tha: "Ruaje qesen e tyre (copën ku ishin futur), numëroji të hollat dhe përdori ato për vete. Nëse vjen i zoti i tyre ktheja ato e në të kundërt shpenzoi për vete!"

Atëherë i shpenzova ato për vete, thotë Ubej.

Më pas e takova Ubejin në Meke dhe më tha: "Nuk e di nëse duhet pyetur tre vjet rresht apo vetëm një vit!"<sup>125</sup>

Ijad bin Himari transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Kush gjen diçka të humbur, le të marrë të dëshmojë një apo dy dëshmitarë dhe mos të ndërrojë as mos të fshehë diçka prej saj. Nëse vjen i zoti i saj, atëherë ka të drejtë ta marrë atë e nëse jo, atëherë ajo është pasuria e Allahut, të cilën ia jep kujt të dojë (d.m.th. ta shfrytëzojë ai që e gjen)".<sup>126</sup>

---

125.Mutefekun alejhi.

126.Ibën Maxheh, Ebu Daud (sahih).

---

## Delet dhe devetë e humbura.

Kush gjen një dele të humbur, duhet ta marrë dhe të pyesë për të zotin e saj. Nëse e gjen, ia kthen atij e nëse nuk e gjen, bëhet pronë e tij.

Ndërsa ai që gjen një deve të humbur, nuk lejohet që ta marrë, sepse nuk është frikë se atë mund ta hajë ndonjë kafshë.

Zejd bin Halid el Xuheni (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thotë: "Erdhi një beduin tek i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe e pyeti për gjënë e gjetur. Ai (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) tha:

"Pyet për të zotin e saj një vit rresht; pyet nëse ndokush e njeh qesen dhe rripin e tyre. Nëse vjen i zoti i tyre, ia kthen ato atij dhe në të kundërt i përdor për vete."

- O i Dërguari i Allahut! Po me delen e gjetur ç'të bëj? – pyeti beduini.

Tha (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): “Ajo është e jotja, ose e vëllait tënd, ose e ujkut.” - Po me devenë e humbur? – pyeti përsëri beduini.

Atëherë ndryshoi fytyra e të Dërguarit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe tha:

"Ç'të duhet ty me të! Ajo e ka me vete ushqimin dhe ujin e saj, pastaj mund të shkojë te uji dhe mund të hajë prej pemëve (pa pasur frikë se mund ta hajë ujku apo ndonjë kafshë tjetër)."127

### **Gjetja e gjërave që hahen dhe atyre pa vlerë të konsiderueshme.**

Kush gjen në rrugë diçka që hahet, i lejohet atij që ta hajë. Kush gjen diçka pa vlerë të konsiderueshme, i lejohet ta përvetësojë atë.

Tregon Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) kaloi pranë një kokrre hurme të rënë në tokë dhe tha:

"Nëse nuk do të kisha frikë se mund të jetë prej sadakasë, do ta haja."128

### **Gjëja e gjetur në Harem (në territorin e Kabes).**

Nuk lejohet marrja e gjësë së humbur në Harem, vetëm në rast se pyet për të zotin e saj përgjithmonë dhe nuk lejohet shpenzimi i saj pas një viti, siç është për të gjeturat në vend tjetër.

Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Allahu i Lartësuar e ka bërë të ndaluar (të shenjtë) Mekën dhe ajo nuk është lejuar për asnjë para meje dhe nuk do të bëhet e lejuar për asnjë pas meje, ndërsa mua më është lejuar vetëm në një orë të një dite. Nuk lejohet në të prerja (lufta), thyerja e pemëve, trembja e

---

127.Mutefekun alejhi.

128.Mutefekun alejhi.

---

gjahut (kafshëve) dhe nuk merret gjëja e humbur në të, vetëm për atë që pyet për të zotin e saj."<sup>129</sup>

## FËMIJA I GJETUR

Fëmija i gjetur, është ai fëmijë i vogël që ka humbur rrugën apo që nuk i njihen prindërit.

### Gjykimi për të.

Marrja e tij është *farz kifaje* (obligim kolektiv), duke u bazuar në Fjalën e Allahut të Lartësuar:

**"Ndihmojeni njëri-tjetrin në punë të mira e të devotshme!"<sup>130</sup>**

### Feja e tij, liria dhe shpenzimi për të.

Nëse gjendet një foshnje (i hedhur) në një vend musliman, atëherë ai është musliman dhe kudo që të gjendet, ai konsiderohet si një i lirë (që nuk është rob), sepse liria është origjina tek njerëzit. Nëse bashkë me të gjendet ndonjë pasuri, atëherë ajo shpenzohet për të e nëse nuk gjendet gjë, shpenzimet e tij i takojnë bankës së shtetit.

Sunejn bin Xhemijleh (një burrë prej fisit beni selim) thotë:

"Më gjetën të humbur dhe më dërguan te Umer bin Hatabi (Allahu qoftë i kënaqur me të!). Ai që më gjeti i tha: "O prijës i besimtarëve! Ky është njeri i mirë."

Umeri tha: "A është e vërtetë kjo?" Tha: "Po." Atëherë Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tha:

---

129.Buhariu.

130.Maide:2.

---

Merre atë dhe dije se ai është njeri i lirë, ti je kujdestari i tij dhe mbi ne janë shpenzimet e tij (mbi pasurinë e shtetit)."<sup>131</sup>

## Trashëgimia e fëmijës së gjetur.

Nëse fëmija i gjetur vdes dhe lë pasuri, por nuk lë pas ndonjë trashëgimtar, atëherë trashëgimia e tij i kalon bankës së shtetit. Po ashtu edhe *ed dijetu* (kompensimi i tij), nëse e vrasin, i takon bankës së shtetit.

## Pohimi i prejardhjes së tij.

Nëse dikush pohon se i gjeturi është fëmija e tij, qoftë pohuesi burrë apo grua, atëherë ai i takon atij, në rast se të qenurit prind i tij është diçka e mundshme.

Nëse pohojnë dy apo më shumë njerëz, atëherë ai i takon atij që sjell fakte. E nëse asnjëri prej tyre nuk ka fakte, atëherë kjo gjë i lihet në dorë specialistit që i njuh prejardhjet sipas shëmbëlltyrës së njerëzve dhe pastaj fëmija i takon atij për të cilin gjykon specialisti.

Aishja (Allahu qoftë i kënaqur prej saj!) thotë: "Hyri tek unë i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i gëzuar dhe me fytyrë të qeshur dhe tha:

"A e di që Muxhzir el Madlexhi vështroi pak më parë te Zejdi dhe Usameja, të cilët kishin mbuluar kokat dhe këmbët i kishin të zbuluara dhe tha: "Këto këmbë janë prej njëra-tjetrës."<sup>132</sup>

Nëse njohësi i këtyre gjërave thotë se ai fëmijë është i dy vetëve, atëherë i takon të dyve.

Transmeton Sulejman bin Jesar nga Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se në kohën e hilafetit të tij një grua shkoi me dy vetë në të njëjtin muaj në kohën e pastërtisë së saj (pas zakoneve). Specialisti tha: "A ta që të dy kanë pjesë në të". Atëherë Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) e hodhi atë fëmijë mbi të dy ata."<sup>133</sup>

---

131.Malik, Bejhaki (sahih).

132.Mutefekun alejhi.

133.Bejhakiu (sahih).

---

## DHURATA

### Ç'është dhurata?

Dhurata është falja e një plaçke dikujt tjetër pa pagesë dhe duke qenë dhuruesi gjallë.

## Nxitja në të.

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Dhuroni që të duheni!"<sup>134</sup>

## Pranimi i dhuratës edhe nëse është pak.

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Nëse do të më ftonin për të ngrënë shpatullën<sup>135</sup> e një kafshe apo kyçin e këmbës së saj, do t'i përgjigjesha ftesës dhe nëse do të më dhuronin një shpatull apo një kyç të këmbës së kafshës, do ta pranoja dhuratën."<sup>136</sup>

## Dhurata që nuk refuzohet.

Azra bin Thabit el Ensari thotë: "Më ka treguar Themameh bin Abdullah, pasi hyra te ai dhe më dha të hidhja parfum, se Enesi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) nuk e refuzonte parfumin dhe thoshte se i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) nuk e kthente parfumin mbrapsht."<sup>137</sup>

Ibën Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Tre gjëra nuk refuzohen: jastëkët mbështetës, gjalpi dhe kosi."<sup>138</sup>

## Kush ka më shumë të drejtë për t'i dhuruar atij.

Aishja (Allahu qoftë i kënaqur prej saj!) tregon se i ka thënë të Dërguarit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): "Unë kam dy komshije, cilës prej atyre t'i bëj një dhuratë?" Tha: "Asaj që e ka derën e shtëpisë më afër derës tënde."<sup>139</sup>

---

134.Bejhakiu (hasen).

135.Shpatulla e kafshës ka qenë pjesa më e preferuar e mishit të kafshës te i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!), ndërsa kyçi i këmbës është diçka pa vlerë që nuk ka mish. I ka përmendur këto të dyja për të thënë që do i përgjigjej ftesës dhe do e pranonte dhuratën njëlloj, nëse ishte diçka e preferuar apo diçka pa ndonjë vlerë të konsiderueshme.

136.Buhariu.

137.Buhariu, Tirmidhiu.

138.Tirmidhiu (hasen).

139.Buhariu, Ebu Daudi.

## Ndalimi nga bërja dallim mes fëmijëve në dhuratë.

Neuman bin Beshir thotë: “Babai im më dhuroi një pjesë të pasurisë së tij dhe nëna ime Amrah bintu Rauaha i tha: “Nuk jam dakord me këtë gjë pa folur me të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!). Atëherë ai shkoi te i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe ai i tha atij:

"A e bërë këtë gjë me të gjithë fëmijët e tu?"

Tha: “Jo”.

"Kini frikë Allahun dhe mbani drejtësi mes fëmijëve tuaj!"

U kthye babai im dhe e ktheu mbrapsht atë që më dhuroi.

Në një transimitim tjetër thuhet se i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) i tha atij: "Atëherë nuk dëshmoj për këtë, sepse unë nuk bëhem dëshmitar për padrejtësi."

Ndërsa në një transmetim të tretë thuhet:

"A dëshiron që të të binden të gjithë njëlloj?"

Tha: “Po”.

"Atëherë mos e bëj atë gjë!"**140**

## Nuk lejohet që ndonjë të kërkojë e të blejë atë që dhuroi.

Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Nuk na shkon për shtat shembulli i keq; ai që kthehet te dhurata e tij, është si qeni që kthehet te e vjella e tij."**141**

Zejd bin Eslem tregon se i ati i tij ka dëgjuar Umer bin Hatabin (Allahu qoftë i kënaqur me të!) të thotë: “Dhashë një kal për në Rrugë të Allahut dhe atij që ja dhashë i humbi. Atëherë doja ta bleja prej atij që e kishte gjetur, duke menduar se do të ma shesë lirë dhe për këtë pyeta të Dërguarin (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e ai më tha:

"Mos e ble atë edhe sikur ta japë me një dirhem të vetëm, sepse ai që kthehet te lëmosha e tij është si qeni që kthehet tek e vjella e tij."**142**



### **Nga kjo përjashtohet prindi që i jep diçka fëmijës së tij.**

Ibën Umeri dhe Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të dy ata!) tregojnë se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Nuk i lejohet askujt që jep ndonjë dhuratë, të kthehet tek ajo, përveç prindit në atë që i jep fëmijës së tij."**143**

---

140.Mutefekun alejhi.

141.Mutefekun alejhi.

142.Mutefekun alejhi.

143.Ebu Daud, Tirmidhi, Nesai (sahih).

---

### **Por nëse ai të cilit i bëhet dhurata, e kthen atë mbrapsht, atëherë nuk ka asgjë që dhuruesi ta marrë.**

Aishja (Allahu qoftë i kënaqur prej saj!) tregon se i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) u fal, ndërkohë që kishte veshur një rrobe të lëmuar me shënime në të. Gjatë faljes i tërhoqën vëmendjen shenjat e saj dhe pasi mbaroi faljen tha:

"Kthejani këtë këmishë Ebu Xhehmit dhe më sillni një tjetër të ashpër, sepse pak më parë ajo ma tërhoqi vëmendjen në namaz."**144**

### **Gjykimi për atë që bën një dhuratë dhe më pas e trashëgon atë.**

Abdullah bin Burejdeh thotë se babai i tij ka thënë: "Një grua erdhi tek i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe tha: "O i Dërguari i Allahut! Unë i dhashë si dhuratë nënës sime një robëreshë dhe ajo tani vdiq. I Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) tha: "Allahu ty të shkroi shpërblim dhe ta ktheu trashëgiminë."**145**

### **Dhurata që marrin nënpunësit është diçka e pamerituar.**

Ebu Hamid es Saidi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thotë: "I Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ngarkoi për mbledhjen e zekatit një burrë nga fisit Ezd, të cilin e quanin Ibnu Letbijeh. Kur u kthye nga puna tha: "Kjo është e juaja, kurse kjo m'u dhurua mua. I dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) hipi në minber dhe pasi falenderoi Allahun tha:

"Si është puna me punëtorin të cilin e ngarkojmë me një punë dhe ai vjen e thotë: "kjo është e jotja e kjo është e imja?". A nuk ulet në shtëpinë e të jatit e të ëmës së tij dhe të shohë nëse do t'i dhurohet gjë apo jo? Beto hem në Atë që ka në Dorë shpirtin tim! Nuk merr ndonjë gjë prej saj, vetëm se do t'i ngarkohet mbi qafë në Ditën e Kiametit..."

Pastaj ngriti duart deri sa pamë të bardhën e sqetullave të tij dhe tha tri herë: "A nuk e përçolla lajmin!".<sup>146</sup>

---

144.Mutefekun alejhi.

145.Muslim, Tirmidhi, Ebu Daud.

146.Mutefekun alejhi.

---

## MARRJA E DIÇKAJE ME FORCË

Kjo është marrja e diçkaje nga dikush, e cila i përket dikujt tjetër, me pa të drejtë.

### Gjykimi për të.

Kjo gjë është padrejtësi dhe padrejtësia është errësirë e madhe në Ditën e Kiametit. Allahu i Lartësuar thotë:

**"Mos mendoni se Allahu është i paditur e i pavëmendshëm për atë që bëjnë të padrejtët, por Ai u jep atyre kohë deri në një Ditë kur sytë do të zgurdullohen prej tmerrit. Atë Ditë ata do të vrapojnë me qafë të ngritur dhe sytë do t'i ngelin nga qielli, ndërsa zemrat e tyre janë bosh dhe nuk mendojnë nga hutimi e paniku."**<sup>147</sup>

"Mos hani nga pasuria e njëri-tjetrit padrejtësisht (me çdo lloj rruge të paligjshme)!"<sup>148</sup>

I Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) në fjalimin (hutben) e lamtumirës ka thënë:

"Gjaku juaj, pasuria juaj dhe nderi juaj, është i ndaluar për ju mes njëri-tjetrit, siç është e ndaluar kjo ditë e sotme e shenjtë, në këtë muaj të shenjtë dhe në këtë vend të shenjtë."<sup>149</sup>

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Nuk është besimtar ai që bën imoralitet kur e bën atë punë. Nuk është besimtar ai që pi alkool kur e pi atë. Nuk është besimtar ai që vjedh kur vjedh dhe nuk është besimtar ai që merr diçka me dhunë dhe njerëzit ngrenë kokën nga ai për ta parë."150

---

147.Ibrahim:42-43.

148.Bekare:188.

149.Sahihul Xhamiu i Albanit (Allahu e mëshiroftë!)

150.Mutefekun alejhi.

---

### **Ndalimi nga përfitimi prej të marrurës me dhunë.**

Për atë që merr diçka me forcë është e ndaluar që ta shfrytëzojë atë, ndërkohë e ka për detyrë kthimin e saj.

I Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Askush prej jush mos të marrë plaçkën e vëllait të tij as duke luajtur, as me seriozitet. Ai që merr shkopin e vëllait të tij, le t'ia kthejë atij!"151

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Kush i ka bërë padrejtësi vëllait të tij (musliman) në nder apo diçka tjetër, le të kërkojë prej tij që t'ia bëjë hallall (t'ja falë) sot, para se mos të ketë dinar e as dirhem. Nëse ai ka punë të mira, do të merret prej tij aq sa të kompensohet padrejtësia e tij; nëse nuk ka punë të mira, do të merret prej të këqijave të atij tjetrit dhe do të hidhen mbi të."152

### **Kush vritet duke ruajtur pasurinë e tij, është dëshmor.**

Është e lejuar që muslimani të mbrojë veten dhe pasurinë e tij, nëse ndokush ka për qëllim vrasjen apo marrjen e pasurisë së tij.

Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thotë një burrë erdhi te i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe i tha: -O i Dërguari i Allahut! Çfarë të bëj nëse një njeri vjen për të marrë pasurinë time? Ai tha:

-Mos ia jep pasurinë tënde atij! Tha:

-Po sikur të më sulmojë?

-Atëherë sulmoje edhe ti!

- Po nëse më vret?

-Atëherë ti je dëshmor.  
 -Po nëse e vras unë atë?  
 -Atëherë ai është në zjarr."**153**

### **Rrëmbimi i tokës.**

Seid bin Zejd (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thotë se ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) të thotë:

"Kush merr padrejtësisht një copë tokë (nga vëllai i tij), do t'i vihet në qafë (Ditën e Kiametit) prej shtatë tokave."**154**

---

151.Ebu Daud, Tirmidhi (hasen).

152.Buhariu, Tirmidhiu (sahih).

153.Muslim, Nesai (sahih).**1**

---

Transmeton Salimi nga babai i tij se i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Kush merr një copë tokë pa të drejtë, do të fundoset deri në shtatë toka në Ditën e Kiametit."**155**

Kush rrëmben një pjesë toke, e mbjell apo ndërton mbi të, urdhërohet që t'i shkulë të mbjellat dhe ta prishë ndërtesën, sepse i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë:

"Nuk ka asnjë të drejtë për atë që rrëmben padrejtësisht."**156**

Nëse ai e ka mbjellë, atëherë i jepen shpenzimet dhe të mbjellat i kalojnë pronarit të tokës.

Rafi bin Hadixh (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Kush mbjell në tokën e dikujt tjetër pa lejen e tij, atëherë atij nuk i takon asgjë nga të mbjellat dhe i jepen ato që ka shpenzuar."**157**

## ESH SHUFAH

### Ç'është *esh shufah*.

Në kuptimin gjuhësor *shufah* është çiftëzimi, ndërsa në kuptimin legjislativ ajo është: kalimi i pjesës së ortakut ose komshiut te ortakun, ose komshiu tjetër, ndërkohë që kishte kaluar tek një i tretë që nuk ka qenë komshi i të parëve, duke i paguar komshiut që shet pjesën e vet shumë më të madhe se ka kërkuar prej atij të tretit.

### Gjërat në të cilat pranohet *shufah*.

Xhabir bin Abdullah (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thotë: "I Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka gjykuar me *shufah* në çdo gjë që nuk është ndarë, por nëse vihen kufijtë dhe ndahen rrugët, atëherë nuk ka *shufah*."<sup>158</sup>

---

155.Mutefekun alejhi.

156.Buhariu (sahih).

157.Tirmidhiu, Bejhakiu (sahih).

158.Tirmidhiu, Ibën Maxheh (sahih).

---

Kështu, nëse dikush ka ortak (komshi) në një pjesë toke, apo në ndonjë mur, shtëpi e tjera si këto, nuk duhet ta shesë pjesën e tij para se t'ia paraqesë komshiut të tij; nëse e shet para se t'ia paraqesë atij, ai ka të drejtë që ta prishë aktin e parë dhe ta blejë vetë atë pjesë.

Xhabiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Kush ka një pemë hurme apo një copë toke, mos ta shesë atë para se t'ia paraqesë komshiut të tij!"<sup>159</sup>

Ebu Rafi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Komshiu më i afërt, ka të drejtë më shumë për të blerë shtëpinë e komshiut të tij."<sup>160</sup>

## Shufah e komshinjve që kanë diçka të përbashkët.

Nëse dy komshinj kanë një rrugë apo diçka tjetër të përbashkët në mes tyre, nuk i lejohet asnjërit prej tyre që të shesë pjesën e tij pa marrë leje nga komshiu i tij. Nëse ai e shet pa lejen e tij, atëherë ai ka të drejtë që ta prishë aktin e parë dhe ta blejë vetë atë.

Xhabiri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Komshiu ka më shumë të drejtë në pjesën e komshiut të tij, kështu që duhet të pritet edhe nëse nuk është pranishëm, kjo nëse rruga e atyre të dyve është e përbashkët."<sup>161</sup>

Ebu Rafi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) tregon se i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Komshiu më i afërt, ka të drejtë më shumë për të blerë shtëpinë e komshiut të tij."<sup>162</sup>

---

159.Buhariu, Ebu Daudi, Ibën Maxheh, Tirmidhiu.

160.Ibën Maxheh, Nesai (sahih).

161.Ibën Maxheh (sahih).

162.Ebu Daud, Tirmidhi, Ibën Maxheh (sahih).

163.Ibën Maxheh (sahih).

---

## AUTORIZIMI

### Ç'është autorizimi (el Uekale).

Autorizimi (el Uekale) është të ngarkosh dikë tjetër në vendin tënd për çdo gjë apo për gjëra të caktuara.

### Gjykimi për të.

Autorizimi është i lejuar, sipas Kuranit, Sunetit dhe Ixhmait.

Allahu i Lartësuar thotë:

"Kësisoj, Ne i zgjuam ata (nga gjumi i gjatë) që ta pyetnin njëri-tjetrin. Njëri prej tyre tha: "Sa kohë keni qëndruar (këtu në gjumë)?" Ata iu përgjigjën: "Kemi ndenjor

ndoshta një ditë apo një pjesë të saj". Pastaj thanë: "Zoti juaj, vetëm Ai e di më mirë se sa kohë keni qëndruar. Tani, dërgoni njërin prej jush me këtë monedhë argjendi në qytet që të gjejë ushqim të pastër e të ligjshëm për të ngrënë dhe t'ju sjellë edhe juve të tjerëve këtu dhe të ruhet që askush mos të marrë vesh gjë për ju!"<sup>164</sup>

Ebu Rafi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) thotë: "I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) u martua me Mejmuneh duke qenë e lejuar (jo me rroben e bardhë të haxhit apo umras, por e kishte kryer atë) kurse unë isha ndërmjetësi i atyre dyve."<sup>165</sup>

Ai (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka pas autorizuar njerëz në kthimin e borxheve, ekzekutimin e ligjeve etj.

Muslimanët janë bashkuar në mendimin, se autorizimi është i lejuar, madje i pëlqyeshëm, sepse ai është një lloj bashkëpunimi në të mira e devotshmëri, kur dihet që jo çdo njeri është i mundur që t'i bëjë vetë punët e tij, kështu që ka nevojë për dikë tjetër që t'i bëjë ato në vend të tij, sigurisht, me autorizimin e tij.

### **Gjërat në të cilat lejohet autorizimi.**

Çdo gjë që i lejohet njeriut ta bëjë me dorën e tij, është e lejuar që ai të autorizojë dikë tjetër në të.

---

164.Kehf:19.

165.Darimi, Ahmed (sahih).

---

### **I autorizuari duhet të jetë besnik.**

I autorizuari duhet të jetë besnik në atë që merr dhe që kryen. Ai nuk kompenson gjë, vetëm nëse prish diçka me qëllim.

I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë:

"Nuk kompenson gjë ai që është mirëbesuar."<sup>165</sup>

El hamdu lilahi rabbil alemin!

---

165."Sahihul Xhamiu" (hasen).

---

## SHTOJCË

### PASURIA DHE GJYKIMI PËR TË Shejh Mesh'hur ibën Hasen Al Selman

Me emrin e Allahut, i Gjithëmëshirshmi, Mëshirploti!

Falenderimet i takojnë vetëm Allahut, vetëm Atë falenderojmë, prej Tij kërkojmë ndihmë dhe falje të gjynaheve tona. I lutemi Allahut të na ruaj nga e keqja e veteve tona dhe prej të këqiave të punëve tona! Atë të cilin e udhëzon Allahu në rrugën e drejtë, ai është i udhëzuar dhe atë që humb Allahu nuk ka kush e udhëzon. Dëshmoj se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është rob i Allahut dhe i dërguari i Tij.

Vërtet që, çështja e pasurisë dhe çka lidhet me të, prej rregullave dhe ligjeve të sheriatit, është një çështje shumë e ndërlikuar dhe për këtë arsye është veçuar në shumë shkrime të njohura nga dijetarë të ndryshëm. Megjithatë, ka mbetur ndoshta pa prekur një çështje; a është pasuria në veten e saj për t'u lavdëruar apo për t'u sharë, ndërkohë që prej teksteve (ajeteve dhe haditheve) përfitohet si njëra ashtu edhe tjetra?

Kështu që dijetarët i kanë konsideruar të dyja anët sipas gjendjes së veçantë.

### **Kur pasuria është e përçmuar**

Pasuria është e përçmuar sipas këndvështrimit të mëposhtëm:

- Pasuria të pengon nga gjërat më të rëndësishme në dynja, siç është bërja e punëve të mira dhe madje mund të jetë shkak për moskryerjen e shumë prej adhurimeve.
- Ajo është shkak për moskryerjen e obligimeve dhe rrugë për në pavëmendësi e rënie në të ndaluara, sepse të kënaqurit me dynjanë është diçka mashtruese dhe dehëse, si alkooli dhe kënaqësitë që tërheqin njëra-tjetrën, derisa ta shpjerë pasuesin e tyre në shkatërrim të plotë (Allahu na ruajt!).
- Sheriati e ka "kritikuar" dynjanë për shkak të zbukurimit të saj dhe të shijuarit e kënaqësive të saj. Allahu i Lartësuar thotë:

**"Ju i morët gjërat tuaja të mira në jetën e dynjasë dhe u kënaqët në të."166**

**"Kushdo që të dëshirojë jetën e kësaj bote dhe vezullimin e saj..."167**



I Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) thotë:

"Ajo që kam më shumë frikë për ju, është që t'ju hapet dynjaja (t'ju vijë pasuri e madhe) ashtu siç iu hap atyre që ishin para jush..."<sup>168</sup>

### **Argumentet për këtë janë të shumta si nga Kurani edhe nga Suneti.**

Ja disa prej tyre:

---

166.Suretu Ahkaf:20.

167.Suretu Hud:15.

168.Buhariu.

---

Pasuria është shkak për llogarinë e gjatë në Ditën e Kiametit, siç ka ardhur në një hadith: "Pasuria e lejuar (hallall) ka llogari të gjatë, kurse pasuria e ndaluar (haram) ka dënim të rëndë".

I logjikshmi e kupton se llogaria e gjatë, është një lloj dënimi dhe largimi sa më parë prej vendit të llogarisë në xhenet, i cili është qëllimi më i madh, ndërsa pasuria të pengon prej kësaj.

### **Kur pasuria është për t'u lavdëruar**

Disa dijetarë të tjerë e kanë kundërshtuar këtë dhe kanë thënë se ato gjëra që thoni për anën negative të pasurisë, janë të vërteta, por ky është një vështrim i shkurtër dhe pa marrë parasysh qëllimin për të cilin është krijuar dynjaja, siç është të qënurit e saj vend për njohjen e së vërtetës apo për meritimin e falenderimit të Atij që e ka krijuar atë.

Madje dynjaja, mund të konsiderohet si thes apo gjah i kënaqësive, duke marrë parasysh anën shtazore të njeriut në të. Kjo është ajo që ka për qëllim grupi i pare, dhe vërtetë që në këtë gjendje dynjaja është pemë pa kokrra, lojë pa seriozitet dhe e kotë pa të vërtetë në të, sepse ai që bën kështu në dynja, nuk ka marrë prej saj, vetëm se: ngrënie, pirje, veshje, martesë e makinë, pa shtuar gjë tjetër. Pastaj këto mbarojnë së shpejti dhe nuk ngel gjë prej tyre.

Por këto janë vetëm ëndrra dhe në fakt ky vështrim tek dynjaja është vështrimi i jobesimtarëve, ndërsa besimtarët e dinë se pasuria është për t'u lavdëruar nga shumë këndvështrime, siç është:

- Pasuria është mirësi nga Allahu i Lartësuar si gjithë mirësitë dhe begatitë e tjera, kështu që, duhet të falenderohet Allahu për dhënien e saj dhe është obligim të kërkuarit e saj sipas mundësisë dhe aftësisë. Kështu, ajo lëvozhgë u mbush dhe u bë kokërr (pemë me kokrra), madje vetë lëvozhga u bë frut, sepse të gjitha janë mirësi, të cilat njeriu duhet t'i arrijë dhe të falenderojë Allahun për to.

- Pasuria të ndihmon në kryerjen e adhurimeve dhe në shumë raste ajo është rrugë që të shpie në kryerjen e disa urdhërave e obligimeve, siç p.sh: ai që e përdor atë për të fituar diçka nga bota tjetër. Thotë i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): "Lum për pasurinë e mirë e cila është në duart e njeriut të mirë!" dhe në një hadith tjetër thuhet: "Poseduesit e pasurive të madhe shkuan dhe i morën të gjitha shpërblimet (sevapet), gradat e larta dhe kënaqësinë e përhershme..." deri sa (i Dërguari Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) tha: "Kjo është mirësia e Allahut të cilën ia jep kujt të dojë." Duke e quajtur kështu pasurinë, si mirësi nga Allahu, me të cilën Ai begaton kë të dojë nga robërit e Tij.

- Ajo që thanë se pasuria do të ketë llogari të gjatë në Ditën e Gjykimit dhe se të pasurit do të vonohen nga hyrja në xhenet, u thuhet atyre: "Kjo është diçka që kthehet në diçka që është jashtë vetë pasurisë. P.sh.: me anë të pasurisë hahet diçka e caktuar, por kjo gjë ka fillime, kushte dhe përfundime të caktuara, të cilat duhen marrë parasysh dhe u duhet kushtuar vëmendje. Nëse ruhen këto, atëherë pasuria bëhet rrugë për në adhurime e bindje ndaj Allahut. Në të kundërt, nëse nuk ruhen këto kushtëzime, atëherë pasuria bëhet shkak për mangësinë apo kundërshtimin (e mësimëve të sheriatit) sipas gjendjes së veçantë.

## Pasuria është dëshirë si të tjerat

Përgjithësisht, pasuria është si dhe të gjitha dëshirat e tjera të njeriut, kështu që ajo ka rregulla, kriteret, kushte, ndalesa dhe rrjedhoja që duhen marrë parasysh. Duhet pasur parasysh këtu se moskryerja apo lënia e diçkaje nga dynjaja është njëllë si kryerja e saj<sup>169</sup>; ashtu siç je përgjegjës për një vepër që bën, po ashtu je përgjegjës për një vepër që e lë dhe largohesh prej saj.

Medito pak ngjarjen që ndodhi ndërmjet Selmanit dhe Ebu Dardasë në hadithin që transmeton Buhariu nga Ebi Xhuhejfe i cili thotë:

I Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) vëllazëroi ndërmjet Selmanit dhe Ebu Dardasë. Një ditë Selmani vizitoi Ebu Dardanë dhe vuri re se Umu Darda (gruaja e Ebu Dardasë) ishte shumë e vrarë dhe e mërëzitur. Ai i tha:

- Çfarë të ka ndodhur?

- Vëllai yt, Ebu Darda nuk ka ndonjë nevojë prej dynjasë.

Vjen Ebu Darda dhe i shtron Selmanit për të ngrënë pastaj i thotë:

- Ha ti sepse unë agjëroj.

- Unë nuk ha deri sa të hashë edhe ti. – i tha Selmani. Pastaj hëngri edhe ai.

Pasi ra nata Ebu Darda u ngrit që të falej dhe Selmani i tha që të flerë e ai fjeti. Më vonë u ngrit përsëri dhe Selmani i tha përsëri të flerë. Kur u afrua pjesa e fundit e natës Selmani i tha:

- Tani ngrihu. U ngritën dhe u falën dhe pastaj Selmani i tha atij:

- Zoti yt, vetja dhe familja jote kanë të drejta mbi ty, kështu që jepi gjithkujt të drejtën e vet.

Ebu Darda shkoi te i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe e lajmëroi për çfarë ndodhi dhe ai tha: "Selmani ka thënë të vërtetën."

Kështu, na bëhet e qartë, se kryerja e një vepre dhe lënia e një tjetre, që të dyja kanë lidhje me llogarinë, kështu që nuk ngel më vend për të sharë pasurinë, sipas këtij këndvështrimi.

---

169.Sepse (lënia) tek dijetarët e bazave të fikhut, është sikur edhe (kryerja) e diçkaje. Ai që kryen vepra të mira për ta parë njerëzit është hipokrit, ndërsa ai që i lë ato (të këqijat) për shkak të njerëzve, kjo lënie e tij është shirk, sepse ai e bëri atë për shkak të tyre.

---

## Ndarja e kundërshtimit

E sakta në këtë temë është se të hash të lejuarën dhe të fitosh pasurinë me rrugë të lejuara nuk mundet që të japësh për të llogari të plotë, por mund të japësh llogari për mosfalenderim për të ashtu siç duhet, qoftë nga ana e mbledhjes dhe fitimit të saj apo nga ana e mbështetjes në të për kryerjen e obligimeve. Kush e llogarit veten e tij në këtë gjë, punon sipas asaj me të cilën është urdhëruar, ai e ka falenduar Allahun për mirësitë e Tij.

Për këtë thotë Allahu i Lartësuar:

**"Thuaj (O Muhamed!): "Kush e ka ndaluar veshjen bukur me rrobat e dhuruara prej Allahut, të cilat Ai i ka krijuar për njerëzit e Tij, si dhe rriskun e pastër? Thuaj ato janë në jetën e kësaj bote për ata që besojnë dhe veçanërisht (vetëm për besimtarët) në Ditën e Kiametit..."170**

Këto mirësi, janë dhuratë nga Allahu për robin e Tij; a ka lezet që robi mos ta pranojë dhuratën e zotëriut të Tij?! Kjo është diçka e papëlqyer në zakonet e mira të njerëzve dhe po ashtu në rrugën e shariatit, sepse qëllimi i dhuruesit është që të pranohet dhurata e tij, dhe dhurata e Allahut për robin e Tij është çdo mirësi që i jep atij, kështu që, ai ta pranojë atë mirësi dhe ta falenderojë Dhuruesin e saj.

Përfundimi është se pasuria duhet të jetë shërbyese për të plotësuar një nevojë të domosdoshme, një nevojë të mesme apo një nevojë plotësuese të së bukurës apo dëshirës së lejuar<sup>171</sup>. Kështu që, duhet mbledhur dhe fituar duke e quajtur si shërbyes apo mjet për të arritur me të diçka të kërkuar e të dëshiruar, duke ditur se të kënaqurit me atë që ka lejuar Allahu i Madhëruar prej ushqimeve, veshjeve e të tjera si këto, është e lejuar ne vetvete; këto gjëra të lejuara janë shërbyese të një baze të domosdoshme, e cila është të jetuarit dhe jeta.

Kështu që pasuria, është e konsiderueshme dhe e dëshiruar, duke u nisur nga e vërteta e saj në mënyrë të përgjithshme dhe jo duke u nisur nga vetë ajo si një element më vete. Pasuria është dhuratë, e cila duhet pranuar dhe nuk duhet kthyer mbrapsht, por jo duke e marrë atë për vetë veten e saj.

---

170.Suretu Araf:32. E forcon këtë gjë edhe fjala e të Dërguarit (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) në sqarimin që i bëri Fjalës së Allahut "llogari e lehtë" në ajetin që thotë: "**Atij që do t'i jepet libri i tij nga e djathta e tij, ai do të llogaritet me llogari të lehtë.**" Ai tha se kjo llogari e lehtë është "el arad" (shfaqja para xhehenemit që do të jetë për të gjithë njerëzit) dhe jo llogaria që përbëhet nga polemika e dënimi. Këtë hadith e ka nxjerrë Buhariu nga hadithi i Aishes (Allahu qoftë I kënaqur prej saj!), ndryshe nuk do të ishin ato kënaqësi vetëm për besimtarët në Ditën e Kiametit.

171.Nevojat janë tre lloje:

- Nevoja të domosdoshme, pa të cilat nuk mund të jetosh dhe ato janë pesë: (feja, atdheu, jeta, mendja, pasuria e nderi). Çdo mjet që ruan këto të pesta, është nevojë e domosdoshme (darura).
  - Nevoja të mesme, pa të cilat nuk humb jeta, por prishet rregulli dhe qetësia në të, siç është banesa e rehatshme, kafsha mbartëse (mjeti udhëtues) etj.
  - Nevoja plotësuese, të cilat zbukurojnë jetën e njeriut dhe ato janë më shumë gjërat e qejfit dhe gjërat zbukuruese, pa të cilat nuk prishet jeta e as rregulli e qetësia e saj.
- 

Në të kundërt, nëse pasuria bëhet shkak për prishjen e një prej bazave të sheriatit dhe lufton parimet e përgjithshme të tij, duke cënuar: nderin, mendjen, trupin, pasurinë e fene, atëherë ajo është e përçmuar dhe ai që e merr këtë lloj pasurie quhet vrapim pas dynjasë dhe dashuri për të shpejtën e të përkohshmen.

Ndërsa nga ana e kundërt e kësaj, është esketizmi (zuhdi), i cili do të thotë lënie e pasurisë së tillë dhe vrapimin pas saj<sup>171</sup>, nëse do të bëhet shkak për të keqen. S'ka dyshim se kjo është ajo që kërkohet prej besimtarit.

Për këtë shkak, mendimi e saktë për këtë çështje është se përçmimi i pasurisë në çdo rast nuk është e drejtë, ashtu si dhe nuk është e drejtë lavdërimi i saj në çdo rast.

Këtë gjë, e bën të qartë çështja e ndalimit të "*sefihut*" (shpërdoruesit të pasurisë pa kriter) nga shpenzimi i pasurisë së tij, për shkak se ai e vë atë jo në vendin e saj. Po ashtu edhe çështja e shpenzimit dhe normave të tij.

Ai i cili ulet dhe nuk punon, e shfaq veten e tij para njerëzve duke zgjatur dorën për të kërkuar dhe i humb e i shkatërron ata që ka për të ushqyer, kjo do të mjaftonte si gjynah për të.

Transmeton Muslimi në Sahihun e tij në kapitullin e Zekatit, se i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Do t'i mjaftonte njeriut ai gjynah që bën kur nuk shfrytëzon fuqinë e tij në atë që ka mundësi ta bëjë!"

Nuk ka kundërshtim se kjo përtaci dhe boshllëk i njeriut nuk është e pëlqyer dhe ai nuk quhet asket (zahid që nuk do dynjanë), sipas kuptimit pozitiv të asketizmit që sqaruar më sipër. Por kjo vepër e tij quhet mendjelehtësi dhe përtaci. Po ashtu edhe shpërdorimi i pasurisë dhe koprracia. Që të dyja këto janë të përçmuara e të papëlqyera.

Ato janë dy cepat e segmentit ndërsa e drejta dhe e mira (hajri) është në mes tyre.

## Sahabët dhe pasuria

Vështruesi i drejtë, i cili nuk e tepron dhe nuk lë mangut diçka në gjykimin për sahabët veçanërisht dhe për selefët e mirë përgjithësisht, gjen që ata (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre!) kujdeseshin për fitimin e pasurisë dhe kishin zanate të ndryshme e të njohura për ta arritur atë, duke e marrë atë si të qënurit ndihmues për të kryer falenderimin e Allahut dhe si anije për në botën tjetër. Por ata kanë qenë njerëzit më asket në të dhe më të drejtët e të sinqertët në fitimin e saj (duke ndjerë mbikqyrjen e Allahut të Madhëruar).

Ibën Hazëm në librin "el Ahlaku ues Sejru" thotë: "Bujari duhet që ta mbrojë trupin e vet me pasurinë e tij, jetën e vet me trupin e vet, nderin e vet me jetën e vet, fenë e vet me nderin e vet dhe mos ta përdorë fenë e tij për të ruajtur gjë nga dynjaja.

Ndoshta i dëgjon këto lajme të tyre për kërkimin e pasurisë, ndokush që mendon se ata e kanë kërkuar atë për të arritur kënaqësitë dhe dëshirat e tyre dhe asgjë tjetër, por kjo është injorim i asaj për të cilën ata e kërkonin atë. Larg dhe të pastër nga kjo janë ata! Ata e kanë kërkuar pasurinë si një nga adhurimet dhe obligimet me të cilat ishin ngarkuar (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre dhe na bashkoftë me ata, na ringjalltë me ta dhe na dhëntë sukses në atë, për të cilën u ka dhënë sukses atyre, me Mirësinë dhe Bujarinë e Tij!)

Nuk njohim askënd që t'i jetë ofruar aq pasuri sa i është ofruar të Dërguarit të Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe ai ia jepte gjithçka që i ofrohej shokëve të tij dhe për të ngritur Fenë e Allahut. Ai (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) e konsideronte çdo gjë që e fitonte me punën e tij, si mirësi prej Allahut dhe se ai ishte i

ngarkuar që ta shpërndante atë dhe të mos mbante gjë për vete, duke arritur kështu gradën më të lartë. Kështu kanë qenë edhe shokët e tij sa që ndonjëri prej tyre ishte si i autorizuar dhe merrte prej pasurisë së tij, atë që i nevojitej edhe pse nuk ishte në gradën e të Dërguarit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!).

## Gradat e njerëzve në lidhje me fatin e tyre në pasuri

S'ka dyshim se njerëzit dallojnë nga njëri-tjetri në marrjen e rrishtit të tyre dhe se shembulli më i mirë për ta në këtë gjë është i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) dhe shokët e tij. Ata nuk mërzhiteshin dhe kërkonin rrishtin e tyre duke qenë të bindur në besimin e tyre, sepse ata i dinin Cilësitë e Allahut dhe se sundimi i qiejve e i Tokës është në Duart e Tij dhe se Ai do t'i llogarisë ata dhe nuk do t'i zhgënjëjë. Kështu që, dëshirat, tekcat dhe simpatitë e tyre u bënë prej gjërave të harruara dhe kthimi tek ato konsiderohej diçka e neveritshme për ta, duke u nisur nga ana e të pasurit në to të drejta për Allahun e Lartësuar.

Më poshtë po sjellim disa shembuj për të argumentuar këtë gjë:

Transmetohet në hadith të saktë nga Aishja (Allahu qoftë i kënaqur prej saj!) se Ibën Zubejri i dërgoi asaj dy qese me të holla (transmetuesi thotë se ishin 180 mijë dirhem) ndërsa ajo kërkoi një tepsi dhe filloi t'i ndante ato për njerëzit. Atë ditë ajo agjëronte dhe kur u ngrys nuk i kishte ngelur asnjë dirhem i vetëm. Në kohën e iftarit i thotë shërbyeses: "Eja ta çelim agjërimin!" Ajo vjen vetëm me bukë dhe vaj. I thanë Aishes: "A nuk mund të blije mish me një dirhem prej atyre që ndave dhe ta haje për iftar?" Ajo tha: "Nëse do të ma kishe kujtuar, do ta kisha bërë" **173**.

Transmeton Maliku se një i varfër i kërkoi Aishes (Allahu qoftë i kënaqur prej saj!) dhe ajo agjëronte e nuk kishte gjë në shtëpi përveç një cope buke. Ajo i tha një shërbyeseje: -Jepja atë copë buke atij!

-Por nuk ke gjë tjetër që të hash iftar. - i tha shërbyesja.

-Jepja atë atij. Atëherë ia dha. Kur erdhi mbrëmja na dhuroi një familje, apo një njeri (i cili nuk na kishte dhuruar ndonjëherë) mish qengji të pjekur sipas mënyrës së tyre të preferuar dhe Aisha më thirri dhe më tha:

-Ha prej këtij sepse ky është më i mirë se ajo copa e bukës."

Transmetohet gjithashtu se ajo (Allahu qoftë i kënaqur prej saj!) ka shpërndarë 70 mijë dirhem, ndërkohë që ishte duke arnosur rrobën e saj. Një here tjetër shiti gjërat e saj me 100 mijë dirhem dhe i ndau ato sadaka, pastaj për iftar hëngri bukë elbi. Kjo vepër i ngjan prefektit të ndonjë prefektore të mbretërisë, i cili nuk merr vetëm se prej mbretit, sepse ai është i bindur plotësisht në ndarjen dhe caktimin e Allahut për të, duke e lënë atë në vend të marrjes së masave për veten e tij. **174**

Nuk ka ndonjë kundërthënie të kësaj me atë që thamë më lart, sepse ky person beson se ajo që ka përgatitur Allahu për të është më e mirë se ajo që përgatit ai për veten e tij dhe nëse ky merr masat dhe prokupohe për veten e tij, atëherë zbret një gradë më poshtë.

\* Disa prej sahabëve e quanin veten e tyre si zëvendës në pasurinë e jetimit<sup>175</sup>, ku nëse ai nuk ka nevojë, nuk e prek atë, e nëse është i varfër e ka nevojë, merr aq sa të plotësojë atë nevojë. Ndërsa në çdo lloj veprimi tjetër, ai vepron si me

---

171.E ka nxjerrë Ibën Sead në "et Tabakat el Kubra", Darakutni, Ibën Asakir, el Hakim dhe Bagaui me zinxhir të saktë.

172.Shpenzimi i pasurisë në rrugë të ndryshme bamirësie është diçka e madhe dhe argument i besimit tek Allahu dhe lënien e çështjes në Dorë të Tij: gjë të cilën e bënë edhe selefët e mirë të popullit (umetit).

173.Ndërsa përpjekja për kërkimin e riskut me rrugë të lejuara, është ajo me të cilën urdhëron dhe nxit sheriati, për të ruajtur krenarinë e vetes dhe nderin e saj. Kështu që, nuk i lejohet askujt që të rrijë pa punë, duke qenë i mundshëm për të punuar dhe të pretendojë se ajo që ka përgatitur Allahu për të është më e mirë se puna e tij. Ai që vepron kështu, nuk është aspak afër së mirës dhe ky pretendim nuk është, vetëm se dukuri përtacie dhe kënaqje me lëmoshën që i japin bamirësit që punojnë: duke u kthyer në fakt në kuptimin se lodhja e njerëzve është më e mirë për të se lodhja e tij!

174.Ka nxjerrë Ibën Shebeh, Ibën Ebi Shejbeh, Ibën Xherijr, Bejhaki etj., se Umeri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) ka thënë: "Unë e quaj veten time në pasurinë e Allahut, si përkujdesësi në pasurinë e jetimit. Nëse kam bollëk nuk e prek atë, e nëse varfërohem, atëherë marr aq sa kam nevojë, pastaj ia kthej atij (jetimit) atë."

175.Ky hadith është i saktë, sipas të gjitha rrugëve e tij. Në një transmetim tjetër thuhet se Umeri (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) ia ka thënë këtë Amari dhe Ibën Mesudit (Allahu qoftë i kënaqur prej tij!) në kohën kur i ngarkoi drejtues në Kufa. Fjala e tij në atë transmetim është: "Unë dhe ju në pasurinë e Allahut jemi..." vazhdon si thënia e mësipërme.

---

pasurinë e jetimit që përdoret vetëm në të mirë të tij. E shpenzon atë aty ku duhet dhe e pengon prej aty ku nuk duhet shpezuar. Nëse ka ndonjë nevojë, atëherë merr prej saj aq sa i mjafton dhe brenda kufijve që i është dhënë leje, duke mos shpërdoruar dhe as shtrënguar me koprraci aty ku duhet shpezuar.

Kjo gjë është gjithashtu, pastrim prej pjesës në këtë arritje të punës së tij. Nëse ai do të merrte pjesën e tij, atëherë do të favorizonte veten e tij mbi të tjerët, por ai nuk e bën këtë, madje e konsideron veten e tij si një prej krijesave. Sikur të ishte shpërndarës për krijesat dhe ta llogarisë veten e vet si një prej tyre.

Transmetohet në një hadith të saktë nga Ebi Musa se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Vërtetë që esharitë (fisi i Ebi Musa el eshari) nëse ngelin të ve, apo u pakësohet ushqimi i familjes në Medine, atëherë grumbullojnë atë që u gjendet në një rrobe të vetme dhe pastaj e ndajnë mes njëri-tjetrit me të njëjtën enë. Ata janë prej meje dhe unë jam prej tyre."<sup>176</sup>

Këtë gjë e hasim edhe në hadithin e vëllazërimit ndërmjet muhaxhirëve dhe ensarëve<sup>177</sup>. Kjo ishte diçka shumë e njohur, të cilën e bënte edhe i Dërguari (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) nëpër luftra<sup>178</sup>.

---

176.E ka nxjerrë Buhariu dhe Muslimi.

177.Transmeton Buhariu në Sahihun e tij nga hadithi i Ebu Hurejrës (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se ai ka thënë: "Ensarët thanë: "(O i Dërguari i Allahut!) Ndaji hurmat tona ndërmjet nesh dhe muhaxhirëve." Ai (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) tha: "Jo." Pastaj tha: "Ata të marrin përsipër përkujdesjen për to dhe pastaj frutat të ndahen mes jush". Ata thanë: "Dëgjuam dhe u bindëm".

Ka nxjerrë, gjithashtu, Buhariu dhe Muslimi nga hadithi i Enesit (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se ka thënë: "Kur mbërriti Abdurrahman ibën Auf në Medine, vëllazëroi i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ndërmjet tij dhe Sead ibën Rabij el Ensari. Seadi i parashtrroi atij gjysmën e pasurisë dhe të familjes por Abdurrahmani i tha: "Allahu të dhëntë begati në familjen dhe pasurinë tënde! Më trego se ku është tregu!" Shkoi në treg dhe fitoi diçka për të ngrënë..."

178.Po mjaftohemi këtu me përmendjen e një shembulli të vetëm, i cili ka ndodhur në luftën e Tebukut. Ka nxjerrë Muslimi në Sahihun e tij nga Ebu Hurejra (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se ka thënë:

Kemi qenë me të Dërguarin e Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) duke ecur për në luftë dhe ushqimet e ushtrisë mbaruan, saqë u detyruan të therrin disa prej kafshëve të tyre mbartëse. Umeri (Allahu qoftë i kënaqur me të!) i tha: "O i Dërguari i Allahut! A nuk i mbledh ato ushqime që i kanë ngelur njerëzve dhe t'i bësh lutje Allahut që ti shtojë ato? Ashtu bëri dhe njerëzit filluan të bienë atë grurë apo hurmë që i kishte ngelur. Thotë Muxhahidi: Dhe atij që i kishin ngelur bërthama i solli ato.

Thashë: Po me bërthamat çfarë bënin? Tha: I thithnin ato dhe pinin ujë me to (që të pinin pak me pika). Bëri dua i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) mbi to dhe ato u shtuan saqë të gjithë njerëzit mbushën torbat e tyre. Pastaj i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) tha: Dëshmoj se nuk të adhuroar tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguari i Tij. Nuk ka ndonjë rob që e takon Allahun (në Ditën e Kiametit) me këto dy dëshmi duke mos patur pikë dyshimi në to, veçse do të hyjë në xhenet." Këtë hadith e ka nxjerrë Ahmedi në Musnedin e tij.

---

Kështu që privilegjimi në kismetin tënd është diçka pozitive dhe që nuk bie në kundërshtim me fjalën e të Dërguarit (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!):

"Fillo (me plotësimin e nevojave) të vetes tënde, pastaj të atyre që ke nën vete!"

Por ai llogaritet si i mesëm në të dyja rastet.

Këta dhe ata para këtyre nuk e kanë kufizuar veten e tyre në kismetin e përkohshëm të kësaj bote dhe ajo që merrnin për veten e tyre nuk konsiderohet si vrapim pas rrishtit, sepse qëllimi i tyre është i qartë dhe kjo duket në privilegjimin e të tjerëve para vetes së tyre, apo barazimin e tyre me veten e tij dhe jo e kundërta, siç ndodh zakonisht.

Duke u nisur prej këtu, themi se këta janë larg pjesës (kismetit) të tyre dhe sikur ta quanin veten të pakismetë. I gjen ata në tregti apo qera, të fitojnë sa më pak të jetë e mundur, madje ndokush prej tyre e kthente fitimin tek shoku i tij dhe jo te vetja. Për këtë shkak, ata e tejkalojnë bamirësinë mbi atë që iu takonte, sepse ata ishin zëvendës të njerëzve dhe jo të veteve të tyre. Atëherë, ku është kismetit i tyre këtu?!



Nuk ka dyshim se këta bashkohen në gjykim me ata të parët, për shkak të ngarkimit të vetes së tyre dhe jo si rezultat i ngarkimit të shariatit fillimisht.

\*Disa të tjerë prej njerëzve nuk e kanë arritur gradën e këtyre të parëve, por marrin atë që iu lejohet ta marrin dhe largohen prej asaj që iu ndaluar duke u mjaftuar me shpenzimin për nevojat e tyre.

Nisur nga kuptimi i mëparshëm, këta kanë ngrënë kismetin e tyre por duke e marrë nga rrugë të sakta e të lejuara.

Nëse këtu thuhet se kjo është zhveshje nga kismetin, kjo thuhet duke u nisur nga mosmarrja e pasurisë sipas dëshirave dhe qejfeve të tyre, por duke konsideruar urdhërat dhe ndalesat në lidhje me të.

Ndërsa kismetin i përçmuar është ai në të cilin nuk njihen kufij dhe vepron si kafsha e cila nuk di veçse të ecë sipas qejfit të saj. Nuk e kemi fjalën për këtë të dytin por për atë që i ruhet hallallit dhe haramit, ai që përgatit vetëm për veten e tij. Ky, sigurisht që nuk vihet në vend të përgjegjësit për dobinë e përgjithshme të muslimanëve, por ai është përgjegjës për veten e vet. Kështu që ky nuk është kujdestar i përgjithshëm, përkujdesi i cili do të thotë zhveshje prej kismetit dhe rriskut tënd.

Mendimi i saktë është se ky grup njerëzish, llogaritet sipas qëllimit që kanë pasur nga arritja e pjesës e cila u lejohet, ndërsa dy grupet e para ndryshojnë nga këta sepse ata i marrin parasysh shkaqet (sebepe), por me qëllim të shpërndarjes së pasurisë.

## **Rëndësia e shkoqitjes në preferencë dhe frytet e saj**

Vëzhgoje me kujdes këtë temë sepse ajo heq shumë prej të dyshimtave me të cilat ballafaqohet vëshguesi në shariat dhe në gjendjet e njerëzve. Kjo temë ndreq shumë prej gabimeve, në të cilat bien ndjekësit e rrugës për në botën tjetër, duke e kuptuar asketizmin, lënien e dynjasë, si dhe kërkimin e saj jo ashtu si duhet. Lavdërojnë atë që nuk duhet lavdëruar sipas shariatit dhe përçmojnë atë që shiariati nuk e përçmon.

Prej dobive të kësaj teme është, gjithashtu, ndarja ndërmjet grupeve kundërshtarë në çështjen e pasurisë dhe varfërisë dhe se varfëria nuk është më e mirë se pasuria në të gjitha rastet, ashtu si dhe pasuria nuk është më e mirë se varfëria në të gjitha rastet. Por zgjidhja e kësaj çështjeje është duke e shkoqitur atë dhe duke thënë që nëse pasuria anon në preferencën e kësaj bote, ajo është e përçmuar në lidhje me kërkuesin e saj, për këtë qëllim dhe varfëria është më e mirë për të, por nëse ajo anon nga preferenca e botës tjetër, duke e shpenzuar ashtu si kërkohet dhe duke u ndihmuar me të për të bërë punë të mira që t'i kesh për "udhëtimin e gjatë" (pas vdekjes), atëherë kjo pasuri është më e mirë se varfëria.

Allahu na dhëntë sukses me Mirësinë e Tij!